

INTERVISTË ME SAMI DËRMAKUN

Prishtinë | Data: 12 tetor, 2022

Kohëzgjatja: 149 minuta

Të pranishëm:

1. Sami Dërmaku (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotni Sami, nëse mundeni me u prezantu, datën e lindjes, vendin, diçka për familjen e ju?

Sami Dërmaku: Po, pas tri motrave që kishin vdekë Sanije, Selvede dhe Mihana, kanë vdekë sa kanë qenë fmi, atëherë kom lind unë, djali i parë. Në vend të Sanije ma kanë lanë mu Sami. Në vend të emrit Selvede ia kanë lanë vllaut mas meje Selver edhe tjetër kesi soji. Domethonë, me 7.11.‘48-ës në fshatin Shipashnicë, familja Dërmaku kam lindë, ku e kom kry shkollën fillore atje, katër vjet. Pastaj, katër vjet tjera i kemi kry në fshatin Hogosht që i thojshin tetë-vjeçare dhe shkollën e mesme. Kam ardhën në Fakultetin Teknik, sepse u bonte rruga e fshatit atje në Shipashnicë, ni rrugë që e kishin bo me kalldrëma.

Baba im punonte gurëthyes. Kurse inxhier i ndërtimtarisë i veshur si zotni me atë, aparatet e përcaktimit të rrogave e disha që e ka rrogën ma të mirë se sot katër-pesë herë a dhjetë herë se baba im. Pata vendosë m’u bo unë vet inxhinier. Mandej kom fillu vitin e parë shkollën e mesme teknike këtu në Prishtinë dhe pasi e kom kry shkollë, pasi sapo pata fillu ni kushe i joni e shitke ni tokë në kufi me neve. U deshke me marrë se qysh ka qenë atëherë mos me hi tjetër aty të hujtë. Vjen më lajmëron baba thotë, “Duhet me ardhë se ne e kemi ble ni tokë, nuk kemi mundësi me të financu për studime”. Jam kthi në shkollën e mesme, gjimnazin “Zenel Hajdini” në Gjilan.

Po kom qenë kështu natyrë duke u kacafyt me serbë e dy profesora, njani Vilkoçi, ati tjetrit ia kom harru emrin, na ka dhanë kushtetutë. Më kanë rrxu në provim, më kanë ngelë në provim. Pastaj kom shku në fshatin, në komunën e Dardanës, sot Kamenica e jam regjistru vitin e parë. Vitin e dytë u pata rreh me serbë (qeshë) dhe më la në provim ni, afër fshatit Kololeç ni shka, Tasiç e ka pasë emrin. E në riprovim mandej e marrë notën tresh, se tjerat i kisha krejt pesshe. Pastaj, duke bo ekcese të tilla për shembull, duke u kacafytë me serbë edhe më përjashtojnë pa të drejtë regjistrimi prej gjimnazit të Gjilanit, të Dardanës.

Kthehem prapë në Gjilan. Gjimnazin aty e kom kry në drejtimin gjuhësor. Mirëpo, drejtimi gjuhësor nuk kishte matematike, dy orë në ditë. Mandej edhe kush na jipke. U regjistrova në Fakultetin e

Ndërtimtarisë nuk mujta. U regjistrova në fakultetin... nuk mujta se ishte plotësu numri. U regjistrova në Fakultetin e Elektroteknikës - tensioni i lartë në Prishtinë.

Anita Susuri: Zoti Sami, po du pak mrapa me u kthy se më thatë që keni lindë në vitin '48...

Sami Dërmaku: Po.

Anita Susuri: Ka qenë diku mas Luftës së Dytë Botërore. Edhe në kohën kur keni qenë ju fmi për shembull viti '58-ta ka qenë kjo periudha famkeqe e Rankoviqit¹...

Sami Dërmaku: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohet juve në familjen e juj apo në fshat çka ka ndodhë?

Sami Dërmaku: Po, po të tregoj se stërgjyshi, te stërgjyshi kanë qenë katër vllazën. Kur u vra i pari e kanë kthy grujën, serbe e ka pasë atëherë. Tash a u martu me dëshirë ai apo me dhunë nuk e di. Ia kanë kthy babgjyshit. Ajo nana e babgjyshit, janë ardhë serbët për me marrë ajo, ajo ka shku ka hy në korub të ni shelgjesh mos me marrë se po e len djalin. Kishte burrin që ai s'kishte pasë faj, po ai s'kishte pasë faj po ia kishin kthy prindërit. Ai i pari, vllau i madh i tij u vra, qysh ka qenë adeti, e kanë kthy. Tash me nanën e vet e marrin shkitë e ngrehin për flokve, e nxjerrin prej korube edhe e marrin e çojnë atje.

Më kujtohet si sot babgjyshi kur shkon, se fmi ka mbetë, e ka marrë... se kur i kanë marrë katër vllazën m'i pushkatu serbët. Njani prej tyne i ka thanë, "O Hasan, mos na harro hajde edhe ti me neve", edhe e kanë vra, i kanë vra pesë vllazën. E tash, babgjyshi ka mbetë jetim. Babën ia kanë vra, nanën ia kanë marrë, por kusheritë e kanë rritë. Më tregonte babgjyshi, se majsha mend unë atëherë, kur shkojshim me pa nanën se e kemi ni kodër në mes fshatit. Më dilte nana edhe më përcillte deri naltë edhe thonte, "O biri nanës", se i vogël, "merre shkom, hyp në shkom, çele magjën maje me kry e merr me hangër". Pas sa kohe u rrita pak ma me kuptu...

Na kemi pasë shumë bahçe atje. Pemë e perime, s'ka pasë pemë që s'kemi pasë aty në vendlindje. Punojshim me shku me shitë pemë. Në Dardanë atje bohej pazari. Më thonte, "Qyre djali jem, qiky shka e ka bajt jelekun e babës tem". Tash unë vet me veti qysh me duru mos me dalë me vra (qeshë). Po ai sigurisht e ka menu me dalë me vra e vrasin edhe këta apo edhe e fusin në burg. Tash, kur ishte aksioni i armëve që ka bo Rankoviqi atëherë... edhe ni Rexhep ka qenë e maj mend. Ai Rexhepi e kanë mundu [aq shumë] saqë e kanë sterilizu. Kur bojshin llaf për torturat edhe mjerimin që e ka përjetu gjatë asaj kohe në borë, në shi.

¹ Aleksandar Rankoviq (1909-1983) ishte një hero partizan serb, i cili pas luftës u bë Ministër i Brendshëm Jugosllav dhe shef i Shërbimit Informativ Ushtarak. Ai vendosi regjim terrori në Kosovë nga viti 1945 deri në vitin 1966, kur u përjashtua nga Partia Komuniste dhe u internua në pronën e tij private në Dubrovnik deri në vdekjen e tij në 1983.

Tani unë të thom të drejtën, se s’kishim ditë se historia ishte krejt serbe, krejt bizantine, s’kishte fare histori tjetër. Mandej për flamurin serb e për kushtetutë e këto tjerat, krejt serbe. Kush ka ditë që ka flamur. Kur u leju flamuri me dalë, se u folte për Titon². Titon, bile unë pata mendu që Tita ma i mirë, e u mundojsha me bo naj vjerrshë s’mujsha me bo. Po Tita ka qenë armiku numër ni. Kur i kujtojsha peripetitë e babës tem edhe të babgjyshit tim që nga aty kam me qenë me mish e me shpirt kundër këtij regjimi.

Ka qenë racizëm, ka qenë shovinizëm. Nxanësit e shkollave të mesme edhe nxanësit që nga fillorja, merre me mend tetë-vjeçare kemi pasë serbishten e na jepke shkau³ na s’merrshim vesh çka osht’ serbishtja. Bile e kemi ni rast, ni koleg, vendas i joni e ka nguc shoku-shokun, ky don m’i kallxu arsimtarit, “Shok Arsimtar, këtij Fatmirit ia lujsha nanën”. “Dil jashtë” (qeshë). Se s’ka ditë qysh me tregu. Ai demek ia ka sha nanën atij. Po thom, ka qenë, kanë qenë... mandej, masanej u ditë diferencimi s’i kanë lanë arsimtarët, s’i kanë lanë familjet e eksponume të cilët kanë qenë kundër regjimit.

Njerëzit e mendojnë që Tito ka qenë i mirë. Po Titoja ka qenë burimi numër një i fatkeqësisë së Kosovës. Ma s’pari ka bo tradhëtinë e Deklaratës të Bujanit⁴. Pastaj, Kosova ka mbetë ma e pazhvilluara. Gjoja se Rankoviqi i ka bo, po Rankoviqi s’i ka bo pa vetëdijen e tyre. E tash Rankoviqi i paska bo. Po more me Rankoviqin kanë qenë edhe tjerë. Sa u dënunë, a sa dolën në shesh krimet edhe kush i ka bo edhe si i ka bo? Ndoshta ka qenë mirë për ta që ka qenë ma keq fillimi. Po diferenca mes zhvillimit të republikave tjera, e sidomos mos të flas të Sllovenisë, gjithmonë ka ardhë t’u u rritë. Ne kemi qenë krahina ma e varfër, bon vaki në Europë atëherë.

Anita Susuri: A ju kujtohet juve si fmi kur keni shku në shkollë, qysh kanë qenë kushtet e mësimi për shembull? Librat çfarë përmbajtje kanë mujtë me pasë?

Sami Dërmaku: Veç fizika, matematika edhe kimia që s’kanë mujtë m’u përzie. Se përndryshe të gjitha... thjeshtë, ligjerimi i tyre ka qenë propagandë. Edhe për ta ngritë historinë e vet edhe që ne mos ta njofim se kush jemi e nga jemi e si kemi ardhë deri aty, sepse ka qenë ni kishë në fshatin tonë, Shipashnicë, te na. Këta jonë mundu me mish e me shpirt me përvetësu. Mirëpo, hymja, hymja e kishës, nuk është përputhë me kishat tjera tash ortodokse. Kishat tjera, tash ortodokse, se s’janë krejt serbe edhe shqiptarët kanë qenë ortodoks.

² Josip Broz Tito (1892 - 1980) ishte një revolucionar dhe burrë shteti komunist jugosllav, duke shërbyer në poste të ndryshme të udhëheqjes kombëtare nga viti 1943 deri në vdekjen e tij në vitin 1980.

³ Shka (m.); shkinë (f.), shumës shkijet, është një term nënçmues në shqip që përdoret për serbët.

⁴ Konferenca e Bujanit është mbajtur më 31 dhjetor 1943 e deri me 2 janar 1944, si rikonfirmim i rrethanave të reja të krijuara pas Mbledhjes së Mukjes dhe Konferencë e Pezës si dhe rezultat i mospërfshirjes së Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën sundimin e ish Mbretërisë SKS, (Konferenca e Bujanit), e cila u mbajtë pikërisht për t’i kundërshtuar vendimet e Mbledhjes së II të AVNOJ -it në Jajcë (29-30 nëntor 1943) dhe mos përfshirjes së Kosovës si subjekt i pavarur që deri atëherë ishte përfaqësuar përmes Malit të Zi në KAÇKJ-së).

Tashi... po ti ki raste për shembull me na ngatërru sikurse sot na kanë ngatërru se ni pjesë dërmuese shkitë i kanë vra shqiptartë për me ua lonë ngatërresën. Se në Hotelin Grand u gjetë materiali çka pas tërheqjes tonë, çka pas tërheqjes tonë. Pas tërheqjes tonë domethonë m'i ngatërru, m'i vra, s'dihet i mesi i shqiptarëve edhe sikurse jemi ngatërru. Unë s'e mohoj që s'ka pasë gabime edhe s'ka pasë hakmarrje edhe s'ka pasë kta... po, pjesa dërmuese. Osht' ni, për shembull, fshati me fshat katolikë edhe muslimanë, ata kanë shku e kanë qit' në bunar derrin edhe janë ngatërru mes veti katolikët dhe muslimanët ose ortodoksët.

Ata të cilët kanë qenë ortodoks, fatkeqësia e shqiptarëve që thojnë vllaznit muslimanë, po jo vllaznit katolikë, jo vllaznit ortodoksë, sepse feja thotë, vllaznit muslimanë shkojnë në xhenet, në parajsë, feja thotë. Po mirë, vllaznit muslimanë, ata arabët zi si futa e buzë shrepët e afrikanët, e arabët e zi, çfarë gjaku kemi me ta? Babgjyshi jem tregonte kur kanë qenë në luftë atëherë në katin përdhesë ishte katolik që derën e kishte vllazën, derën e kishte nër shkallë. Kurse vllau tjetër musliman ishte në katin e parë. E tash po i thom babës tem se ai qashtu po menon, "Jo feja muslimane", "O babë, babgjyshi, baba yt ka tregu që në Prizren dy vllazën prej nanës njëni katolik, njëni musliman. Qysh ata s'munën me qenë të ni gjaku kur ni nanë i ka bo?" Prandaj neve feja...

Mandej, m'u dashtë me detyru hoxhën, e kisha kojshi, "Hoxhë, kallxoji", thashë, "a dy katolikë prej ni nanës, a dy vllazën prej ni nanës, njani katolik tjetri musliman, a janë me gjak të njejtë apo?" "Po", tha, "edhe me katolikë?" "Po krejt edhe me ortodoksë jemi vllazën të ni gjakut". Atëherë baba jem s'kishte nevojë me më thonë, po thonte, "Hoxha ka thanë, jo Sabria", (qeshë). Po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu qajo jeta në shkollë? A ka qenë larg shkolla? A ka qenë vështirë për juve?

Sami Dërmaku: Jo, jo shiko. Tash shkolla në fshat ka qenë afër aty, po mendoj. Po në fshatin Hogosht osht' ni përpjetëze e duhet me dalë te arat e gjata, rruga quhej, serbisht Dugi del i thojshin. Domethonë, gati ni orë kemi bo dej kemi shku. Prej vitit të pestë, borë, shi, ne u dashtë me qenë në kohë në msim. Për shembull, ka pasë aty edhe do prrocka kur u çojshin, kur bijke shi, vërshimet aty ishte problem me dalë, me kalu për me mujtë me mrri te shkolla atje. Po, tash në fshatin Shipashnicë, msusi i parë ka qenë [Metush Krasniqi](#). Për Metushin keni dëgju?

Anita Susuri: Ëhë.

Sami Dërmaku: Unë nuk e mbaj mend, po domethonë që msusi i parë ai ka qenë. A e mbaj mend Sejdi Kryeziun, dajën e [Hydajet Hysenit](#). Domethonë, frymëzimet e para fshati Shipashnicë i ka marrë prej mësuesve patriotik të cilët kanë vazhdu... e pastaj kur shkum në klasën e pestë, gjashtë kishim ma shumë arsimtarë, a din, ma shumë mbahej ligjerimi... unë mbaj mend në shkollën e mesme më ka dhanë njëni që s'e di a e kish kry tetë-vjeçaren a jo. Çka dinte ishte shkrim, lexim se s'kishte kuadra. E

mandej, në fshat aty, ka qenë baba i Xhevdet Sylës, ka vdekë, ka qenë në grup me Nezir Mytën. I cili ka qenë në celulë me Hydajet Hysenin.

Anita Susuri: E në këtë kohë sa ju keni qenë në shkollë fillore, deri në klasën e tetë për shembull a keni ditë që ekzistojnë këto grupet ose diçka...

Sami Dërmaku: Jo, jo. Unë po të thom, unë kur jom shku në shkollë të mesme qatëherë se s'kemi ditë çka osht' flamuri, çka ekziston... ne e kemi ditë që... se Metush Krasniqi, Sadri Shipashnica, ka qenë komandant i brigadës në Kikë. Luftën e Kikës që e kanë luftu, i kanë ndalë malazezët i kanë depërtu. Ata janë... mandena ata ishin ideal, ideali yni. Vujtjet e torturat që ka pësuar Metushi. Mandej, ky Metë Dërmaku që ka qenë edhe si administrator në komunë, po ka pasë edhe lidhje me këta. Tash materialet që kanë pasë kta, i kanë zanë në arkë të teshave, i kanë nxjerrë. Tash ky ka thanë, "Valla unë jom analfabet, më kanë thanë ruq qito edhe i ruq", edhe s'i ka thanë [me i zbulu] shoktë, po edhe vetën e ka shpëtu.

Anita Susuri: E kur po thoni që keni shku në Prishtinë, në shkollë teknike. A ka qenë kjo hera e parë që keni shku dikund jashtë?

Sami Dërmaku: Po, po, hera parë.

Anita Susuri: Si osht' dukë Prishtina në atë kohë?

Sami Dërmaku: Po Prishtina qashtu qysh... në krahasim me viset tona atje me Dardani e krejt, diçka ishte ma, ma, sado pak kishte diçka. Se Prishtina tona herat si, si kasa...

Anita Susuri: Kasaba, qytezë.

Sami Dërmaku: Po pra. Masanej u zhvillu kadal, kadal.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë qito vitet për juve? Po thoni që në shkollë të mesme keni fillu, si me thanë, m'u njoftu me këto grupet...

Sami Dërmaku: Po.

Anita Susuri: Që po ekzistoka ni lëvizje e tillë...

Sami Dërmaku: Shiko, unë po flas... detyra jonë me i rreh serbët të cilët ishin (qeshë). Për qita jom përjashtu edhe jom... sepse shifej racizmi, urrejtje patetike. Shiftari, shiftari⁵, *shiftarski jezik* [srb.: gjuha], *albanski jezik*, nuk jemi njojtë demek. Domethonë, na krejt tjetër popull, me ni gjuhë krejt

⁵ Term derogativ që serbët e përdorin karshi shqiptarëve.

tjetër. Sikur tash që po thojnë shtet Kosova, shtet Shqipëria. S'ka, ka komb kosovar, s'ka komb shqiptar, komb shqiptar është Shqipëria. Po veç me qenë shka i biri shkinës me pagu kumeditë sa edhe m'i thanë këto fjalë. Kombi kosovar.

Isha me ni pushim në Shëngjin, jo në Shëngjin, në Velipojë. Nji artist i Shkodrës, nejse në fillim muhabeti na pëlqej. Po thotë, “Kemi kongresin e dialektit geqe”, domethonë gjuha gegnishte nifare mënyre. Thashë, “O zotni, serbi me mish e me shpirt u mundu me na bo të ndryshëm nga ju. Juve ju ka kujtë *albanci* [Srb: shqiptar], neve në Kosovë i qujnë shiptarski”, se jo shqiptari, thashë, “për të na tregu që ne jemi të ndryshëm nga ju. A ne ni gjuhë, ni traditë, ni kulturë. Nëse ti don me bo këto, për çfarë arsye don me bo? Me ndjekë rrugën e serbëve?” Edhe masanej u pat' prishë me mue, s'i erdh mirë. Se tha, “Të pres si mysafir i veçantë në Kongresin e Tosknishtës”.

Anita Susuri: Po ju atëherë si i ri i keni pasë këtë ide me thanë ideologji me u bashku Kosova edhe Shqipëria. Edhe ka qenë, domethonë jo pjesë po ka qenë si kryesorja në këto lëvizje m'u bashku Kosova me Shqipërinë...

Sami Dërmaku: Kështu, tani, pas '45-tes masakrat e Tivarit, masakrat t'u i marrë njerëzit t'u i çu në mal. Mandej Gradishta, ky Mehmet Gradishta. Lufta, brigadat e Shqipërisë që janë në emër të komunizmit e m'i, reaksionarin gjoja me luftu... shiko, tani, kur thuhet se marksist-linist ekstrem, ideja jonë ka qenë rregullisht bashkim me Shqipërinë. Jemi ni popull, ni komb, kemi t'drejtë ni shtet. Na luftonim kundër kësaj Jugosllavie. Bile, mu më kujtohet kur në burg kom qenë më kanë thanë, “Qy, qy, kujna i kemi dhanë bursë”, se e merrsha ni bursë, “na me tenka, me aeroplana, ju po doni me na mujtë neve”.

Tash ishte jashtëzakonshme ushtria e Jugosllavisë ta quj, një ndër ma të fortat në Europë. Tash nëse ne kishim synim m'u bashku me, me shtetin amë Shqipërinë, dy të ngjashme mund të bashkohen apo jo, dy të kundërta kurrë s'bashkohen. Na tani po luftojmi okupatorin, me pamfletë e me krejt. Qysh ka thanë ai UDB-ashi edhe me gurë, e ata me tenka, me aeroplana. Tash nuk mujshim ne me luftu Jugosllavinë, po mendoj okupatorin edhe luftoje shtetin amë se qenka marksist-liniste. Na dilke për hunde sado e fuqishme që ishte, sado masakra e tortura që krijonin, protesta që zhvilloheshin.

Tash në qoftë se janë, Shqipëria amë që po i thojnë ish marksist-liniste, po ne s'mujshim me u bo as ballistë. Se s'ka pasë as ballistë, s'ka pasë as çetnikë në Jugosllavi. Ka qenë grupi komunist i malazezëve, komunist ka qenë po ka qenë ma radikal i ka fut në burg. Domethonë, s'ka pasë dy rrugë. Kundër okupatorit, qat Shqipni çfare ishte u dashke me pranë edhe ne si organizatë marksiste-leniniste. E dyta, çka ka randësi çfare ke qenë? Ka randësi që ti e ke luftu armikun, ke shpërnda parolla transparente për shfrytëzimin ekonomik, për taktimet në mënyrë kriminale.

Çeng shi ampingu ju ka thanë kur ishte Mao Ce Duni gjall, “Nuk osht' me randësi masa çfare osht', me randësi osht' a gjun mirë”. E tash, edhe ne nuk osht' me randësi çfare kemi qenë po me randësi e kemi

luftu armikun. E këta tjerët kanë bo sefa me atdhe, pozitat e mira, rrogat e mira, ecë kah të dush edhe s'ka ça kokën me çashtjen e robërimit të Kosovës.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Ishit t'u më tregu ma herët për shkollën teknike, për shkollën e juj...

Sami Dërmaku: Po.

Anita Susuri: Pastaj përjashtimet, këto problemet që i kishit me popullin serb që keni pasë, që kanë qenë shokë shkolle me ta...

Sami Dërmaku: Po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj kjo? Faktikisht si jeni njoftu me këto grupet?

Sami Dërmaku: Si?

Anita Susuri: Si jeni njoftu me kto grupet që...

Sami Dërmaku: A po.

Anita Susuri: Që po ekzistojkan grupe të tilla. Si e keni marrë vesh?

Sami Dërmaku: Po, po. Ne, unë tash kur jom regjistru në Fakultetin Teknik, aty kanë qenë Osman Dumoshi në maqineri, Afrim Loxha ka qenë, qysh e pat' emrin more ky, nejtse. Domethonë edhe qarkullonte libri, "Tradhëtia", e Resulit. Po ka qenë atëherë shumë shpejt me marrë me lexu se u dashke dorë pas dore... Skender Muqolli ma jep mu librin e "Tradhëtisë". Tona bisedat me Afrim Loxhën e shoktë e tij, Osman Dumoshin, Skender Muqollin u zhvillu ajo që ilegalja po vepron. Por unë kisha vendosur studimet m'i kry ma së pari.

Pastaj, shpejt u njoftum te Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Isa Kastrati, Sali Malaj me motrën Qefsere Malën, Shyhrete Malën edhe vllaznitë. Nuhi Berisha vepronte me këtë grup, me Malaj. Mirëpo, disa aksione bashkë me Rexhepin i kryshim, për shembull, se Kadri Osmani banonte në shtëpinë time në Breg të Diellit. E bonëm celulën treshe me Sherif Masuricën dhe Kadri Osmanin. Unë e mora përsipër që t'i furnizoj me teknikë, kështu që edhe kisha masanej duke kry ato aksione. Mandej kisha obligimin edhe m'i vazhdu studimet. Një nga ato aksionet që e pata kry atëherë, e rrëmbeva shaptilografin e Fakultetit Teknik në ndërtesën e vjetër, aty te Fakulteti Ekonomik, në këtë anë rrugës dhe i jap...

Anita Susuri: Shaptilografi ju ka vyjtë për m'i...

Sami Dërmaku: Po, për m'i shumëzua ato. Kur ka dalë Kadri Osmani në shpi të vet masi ni kohe që ka banu [te unë], ia kanë zanë në bunkerin që e ka bo në shtëpinë e vet. Pastaj, meqenëse doja me kriju praktikën në këtë ndërmarrjen e Elektro-Kosovës, shkoja te Ismet Grajçevci ishte inxhinier. Ai kishte veç me ma dhanë nënshkrimin kishe e kryjta praktikën, po me rëndësi isha i lirë. Një ditë prej ditësh p'e shoh ni fotokopjues e kishin qit' në koridor. Bile, ka dhanë këtë deklaratën, ky Ismeti. Edhe p'e pys, "Ismet", thashë, "çka osht", thashë, "ky shaptilograf", thashë, "pse e keni qit' ktu?" Tha, "E kemi marrë ni të ri edhe e kemi qit' aty". Vet me veti edhe me ua marrë keq s'po ju lishim.

Kaloj me Rexhep Malën aty pari, po i thom, "Rexhep, qitu në koridor osht' ni shaptilograf, po veç duhet ta thej qat' dritë qaty", se ishte ajo drita publike. Thashë, "Edhe me kry, me rrëmby". Tha, "Shiko çka po të thom, mos gabo ti me bo këtë punë se ti po frekuenton shpesh këtu", se në Elektro-Kosovë, inxhinier i elektros, i tensionit të lartë. "Le këtë punë, unë e kryj", "Jo, jo". "Nëse don", tha, "me shku në burg e m'i çu edhe shoktë në burg kryje ti aksionin. Po ti nuk bon, frekuenton shpesh dyshojnë edhe ashtu kanë me dyshu". Kur ni ditë po kaloj aty pari, p'e shoh dritën e thyme thashë e paska fshi Rexhepi, Rexhep Malaj.

Anita Susuri: E ai shaptilografi a ka qenë shumë i madh?

Sami Dërmaku: I madh, po qysh jo, i madh ka qenë. Ma i madh se qajo {tregon me duar tek një objekt në dhomë}. Po ka shku mandej Hydajeti, Ilmi Ramadani, katër pesë veta e kanë marrë e kanë qit' për dritare, po.

Anita Susuri: Çka kanë qenë aktivitetet tjera? A keni shkru parulla? A keni shpërnda këto?

Sami Dërmaku: Po, po, po. Kryesorja e jonja ka qenë, e jemja ka qenë kryesorja m'i furnizu me teknikë. Besoj që mirë e kom kry (qeshë). Organizata ka shpërnda pamflete, kanë shku në dom të studentëve. Në anën tonë në Topanicë, në Hogosht, Rexhep Mala që ka kry me shokë. Mandej e ki në Trepçë, "Trepça punon Beogradi ndërton", shfrytëzimi ekonomist, ka pasë parulla. Ka pasë mandej edhe forma se si duhet të jetë konspiracioni. Tash nëse unë kam qenë tresh me Kadri Osmanin, Sherif Masuricën do të thotë, por unë treshin e Kadrisë nuk e kam ditë. As Kadria nuk ka mujtë me ditë treshin tim ose të Sherifit apo të Rexhep Malës.

Unë me Rexhepin kemi nejtë e kemi bisedu e kom shku edhe atje në Hogosht, po mendoj, atje në Gjilan ku ka pasë shpijën, ka ardhë edhe te unë. Rregullisht kemi diskutu. Unë e kom marrë vesh që Rexhepi është i organizum përmes "Tradhtisë", librit "Tradhëtia", se ai e kish lexu para meje e u mundojke me më sqaru. Ka qenë strikte: del në takim, ki me shku para kohe dhe 15 minuta më pret edhe vazhdon, nuk më pret ma.

Anita Susuri: Takimet ku i keni bo zakonisht?

Sami Dërmaku: Po nëpër banesa. Nëpër banesa. Për shembull, mu më thojnë, e ki ni takim me Hydajet Hysenin te Medresja aty në skej, osht' ni prrockë aty. Paraprakisht kom shku për ta ditë vendin që kur të shkoj mos të vonona t'u e lypë se tana bi në sy. Mirëpo, lagjen që kom qenë thuti krejt sytë e UDB-së jonë konë. Unë për me dalë, ni takim për me pasë u dashke m'u nisë gjysë ore apo ni orë përpara me mrri. U deshke me kcy ka fqinji im murin me dalë në atë anë mos me dalë në rrugën kryesore se të përcillnin, po edhe anej ka mujtë me të përcjellë se ke qenë i rrethum.

Anita Susuri: E ajo lagje pse ka qenë qaq shumë...

Sami Dërmaku: Bregu i Diellit.

Anita Susuri: Po. Pse?

Sami Dërmaku: Ilmi Rakovica, po, Ilmi Rakovica.

Anita Susuri: A ka pasë shumë njerëz që kanë jetu aty që kanë qenë...

Sami Dërmaku: Po, po, ka qenë lagje e tërë, shpija në atë anë e në këtë anë...

Anita Susuri: Po du me thanë, pse osht' mbikqyrë qaq shumë prej UDB-së?

Sami Dërmaku: Jo prej UDB-së, po ata si argatë të UDB-së na kanë mbikqyrë neve.

Anita Susuri: Mendova që direkt i keni pasë.

Sami Dërmaku: Jashar Aliu thotë, s'e di a e keni intervistë ata a jo, tha, "Pse s'ke dalë në takim me Hydajetin?" P'i thom, "S'kom mujtë me dalë". Përndryshe, po dola kom qenë i përcjellun na kishin burgosë edhe Hydajetin edhe unë kisha shku. Se s'kemi dalë aty, jemi dalë për marrëveshje. I lutem i thom, "Buj, rri te une". T'u shku rrugës e burgosin. Kur ka dalë prej burgut i thom, "A u binde se ka qenë e përcjellun shpija a jo?" Tha, "Po, po e hongra vet". E qishtu.

Anita Susuri: Këto kanë qenë fundi i viteve '70-ta apo viti '80 ka qenë? Kur keni qenë në fakultet ju?

Sami Dërmaku: Tash shiko, unë vitin e parë kur e kom kry '68-'69...

Anita Susuri: Ah, ma herët.

Sami Dërmaku: Po protestat janë bo këtu kur kom qenë një nga aktivistët. Unë vllaun e kom pasë ushtar. Prandaj, unë u deshtë me ndërpre se për ni provim nuk mujta me kalu me regjistru vitin. Punova në fshat, në fshatin Shipashnicë si arsimtar. Sa ka përfundu viti shkollor... se ka qenë rregull, dy anëtarë të familjes nuk mundën me qenë ushtarë. Mirëpo, duke u frikësuar ata se po përsëritet '68-ta më çojnë edhe mu ushtar më çojnë atje. Bile i pata shkru ni letër kryetarit të komunës çka s'i pata thanë. Para se me shku ushtar krejt hypën, unë s'hypa në autobus për me shku. Edhe u thom, "Medet kujt i duhet me kry ushtrijen". Shkon polici, dhondërr i kushërive tanë, burri i ni kushërirës tonë e lajmëron shefin, shefin e Sigurimit Ushtarak, a si u qujshin atëherë nëpër komuna...

Anita Susuri: Si kryesues, a diçka qishtu.

Sami Dërmaku: Jo, mër jo. Ka qenë zyre e posaçme për çështje ushtarake, për sigurime e për këto. Ka qenë Rada Trajkoviçi u qujke. Shkon e lajmëron ata, qishtu ka thanë Sami Dërmaku. Më çojnë... dy policë më marrin më çojnë te zyrja e tij. Tha, "M'u çu", tha, "t'i thej eshnat njo ka njo", thashë, "Të mi thejsh krejt eshnat, qita të ma lajsh gjallë {bën me shenjë tek gisht} i boj me gisht". "Qysh p'i thu ti mikut..." Mandej shkova me vonesë ushtar për një dhjetë-15 ditë. E disha që mos me shku, si dezertër e han dënim të fortë. Kështu masanej unë u ankojsha se kom smundje.

Ni mjek po më thotë... shkova m'u lajmëru si i smutë aty. Thashë, "Kështu kom këtë smundje, këtë smundje", p'i tregoj. Po tha, "I kahit je ti?" Thashë, "I Gjilanit", "Bash i Gjilanit?" Thashë, "Jo i Kamenicës". "Bash i Kamenicës?" Thashë, "Po i Shipashnicës", "A ke ngat Hogoshtin?" Thashë, "Po". Ma murrë mendja që dikush i ka bo mirë atij. "A po don", tha, "me shku te shpija", thashë, "Jo, unë po du m'u shëru". "Pse?" "Po du m'u shëru", thashë, "se ti e din qysh osht' te na, me dalë prej ushtrie invalid thojnë paska behane djali" (qeshë). Thashë, "Unë s'un gjej nuse m'u martu". "Mendoje!" Vet me veti rash në kurth. Ma çon në Sarajevë udhëzimin, ma jep Sarajeva që shumë i pa aftë.

Tash si duket unëm masiqë jam shku 15 ditë me vonesë, këta s'e kanë çu dokumentacionin, shënimet personale kush tek. Tash ka qenë ni flamurtar, tash ishte ardhë, mu më kishte ardhë vendimi që me lanë, me lshu. Tani e marrin me vonesë materialin, dosjen time. Tha, "A ke qenë në burg ti najherë?" "Po more qysh jo". "Ha?" Se edhe aty pata bo probleme. Thashë, "Po more". "Për çka?" "Po, për rrahje, për qisi probleme". "Jo, jo, na p'e dimi për çka paske qenë nëpër burgje, po vonë e morëm vesh". A vllavin e kisha në Banja Llukë. I pata thanë, "Mos u lajmëro ti qito ditë se jemi në teren". Se vllavi thonte, "I kom edhe qikaq ditë, po baci m'i bo edhe 360 ditë çka ka me bo". Ish kanë lajmi që vllau po të pret se ka shku, e vizitova, po të merr te dera. "Qysh more te dera sa ka shku?" "Jo valla, civil ka ardhë".

Anita Susuri: E deshta me ju pytë e përmendet demonstratat e vitit '68 që keni qenë pjesëmarrës...

Sami Dërmaku: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë krejt kjo? Organizimi në qat' ditë?

Sami Dërmaku: Tash osht' caktu vendi. Novosella përpara ka marrë përsipër i ka qit' flamuj edhe parollat, transparentët para, te Fakulteti Filozofik. Po të gjithë kanë qenë të lajmërum, po nuk janë dalë në shesh. Kur kanë thanë se ora qikaq, ti thu sikur lumenjë kanë vërshu edhe kanë dalë në protestë. T'u i tregu shoku pas shokut. Protesta ka qenë shumë interesant. Po ka pasë edhe parolla ka pasë po, kanë qenë ato për universitet e për të drejtat e barabarta, për lirim ekonomik, për hapjen e universitetit, flamurit e tjera, Kosova Republikë. Bile, unë e kom pasë 30 vjetorin e '68-ës në 2008, referatin për protestat e Prishtinës. Mandej janë organizu Gjilani, janë organizu Prizreni, Peja. Masanej edhe në Maqedoni ka dalë për protesta. Kështu që ka shku zinxhirë ka qenë shumë.

Tash protestat e '68-ës, regjimi serb osht' marrë si lubi⁶, si djalli vet, krijesa pa shpirt e pa zemër, pa, egërsina, osht' thy akulli. Pastaj kollaj osht' me bo protesta. Kur u bon protestat e '68-ës secili ka mendu çka pësojnë. Po fatbardhësisht ka qenë ajo si thojnë era e shkumjes së Rankoviqit edhe e liberalizimit, po. Se mandej ti demonstratat janë bo edhe ma të mdhaja, janë bo edhe këtu. Po kur i bon të parat, aty vërtetë u ndjeje ajo frika se me çfarë regjimi kemi të bajmë. Kur e kemi ditë edhe historinë e para, vepruesve para neve çfarë tmerri kanë pësuar.

Anita Susuri: Demonstratat a kanë qenë në numër të mdhaja shumë?

Sami Dërmaku: Po, po, po.

Anita Susuri: A ka pasë edhe studentë, a veç kështu?

Sami Dërmaku: Po, u vra aty u vra Murat Mehmeti u vra. Unë kam qenë sikurse me juve afër, veç u rrutullu, se u gjujtë prej kasarnës nën koridorin e objekteve. Tana kanë hy edhe serbtë kanë hy aty, "Rrnoftë Enver Hoxha. Rrnoftë Shqipnia!" Dojshin m'i dhanë kahje të kundërt protestave.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë pasojat e atyne protestave?

Sami Dërmaku: Po tana fillunë, fillunë provokimet e serbëve nëpër ballkone t'u qit' ujë t'nxehtë e me vazo të luleve. Atëherë u pezmatu masa edhe fillunë krejt veturat çka ishin për t'i përmbysë. Bile, ka qenë ni kusheri, doktor shkence, Ismet Dërmaku, ai grujen e ka pasë shkinë⁷. Unë pas demonstratave shkojsha me marrë vesh çka po ndodhë (qeshë), se ai ka qenë drejtor arhivi atëherë. Ajo gruja e tij shkinë po më thotë, "He Sami", tha, se ata kanë pasë veturë, "me pasë qenë na me veturën tonë çka kishe bo ti?" "Veç kisha thanë mbyllne derën, mos e çelni. E kisha praptu". "Shif Ismet, p'e man gjarpnin në shpi", p'e pranon. Katrorët e gurëve t'u i hjekë tu i praptu, patën bo...

⁶ Figurë e mitologjisë shqiptare, që përfytyrohej si një gjarpër keqbërës shumë i madh, me bisht të gjatë, me disa krerë dhe i pangopshëm, i ngjashëm me kuçedrën.

⁷ Term derogativ.

Anita Susuri: Ato kalldërmat?

Sami Dërmaku: Po de, kalldërmat. Pastaj, erdhën me autobus zjarrfikësit patëm hypë unë edhe Isa Kastrati mbi kulm të autobusit me parolla transparente edhe tana zbritëm. T'u zbrit, pas meje ishte me plis ni djalë i ri edhe ia mshoi polici atij. Thashë, "Pse po ia mshon atij? Pse e ka plisin a?" M'u pat' afru edhe mu në hundë edhe me ni faculetë menzi e kom nalë gjakun. Unë me atë parollën që ka qenë me kornizë të drunit anash e kisha çu përpyetë me ia mshu atij. Ai kokën qishte {duart në kokë}, kur e ka çu unë parollën {shpjegon me duar gjujtjen në kokë të atij}. Mirëpo, tana Isa Kastrati, i ndjeri, e rrethun policia aty. Ai me ni rrëmetë sikur kur i pret qentë. I thom, "Ik sa ma parë se je keq" edhe mezi shpëtoi. Tani Hasani që thashë Hasani që ka qenë njëri nga organizatorët, se ai ka qenë ma i vjetër se unë, ka qenë i trullosur krejt në tana antë, e kanë marrë shoktë e kanë tërhejkë.

Anita Susuri: E a ka pasë në atë kohë, për shembull, domethënë në '81 janë burgosë ni numër shumë i madh i njerëzve...

Sami Dërmaku: Po, po.

Anita Susuri: Po në '68-ën a ka pasë shumë?

Sami Dërmaku: Jo, ka qenë [Selatini \[Novosella\]](#), Adil Pireva, Ilaz Pireva, domethënë qita në krye, Afrim Loxha, Skender Muqolli. Kanë qenë Hasan Dërmaku, pesë vjet ka qenë i dënum. Skender Kastrati që kanë qenë organizatorët kryesor këta. A anash kanë qenë Metush Krasniqi, Ismail Dumoshi, Hyrije Hana, që janë konsultu, po.

Anita Susuri: A ka pasë prej ktyne që i kanë marrë njerëz prej demonstratës që i kanë burgosë?

Sami Dërmaku: Hasanin e kanë marrë. Hasanin e kanë marrë, masi, më duket se më ka thanë se te "Orioni" ka hi me pi kafe. Selim Brosha me njërin kanë shku e kanë marrë e kanë çu në burg.

Anita Susuri: Qysh ka qenë pastaj krejt situata qat' ditë pasi osht' shujt pak ose osht' tejkalu ajo?

Sami Dërmaku: Jo atëherë ka qenë zhurma e Komitetit. Shqiptarët tu i ngrehë shiptart. Tana...

Anita Susuri: A ka pasë naj...

Sami Dërmaku: Tana ka pasë edhe shkrime irredentiste, nacionaliste, armiqhtë e popullit, deshtën me na prishë Vllaznim-Bashkimin e këto përralla. Vllaznim-bashkimi për ata se ishin bo jugosllavë. Unë kom qenë gjeneratë me Azem Sylën, [Azem Vllasin](#). Pas demonstratave, greva e parë ka fillu në Fakultetin Teknik që kom organizu me ni shok të Mitrovicës, Ferki e ka pasë [emrin]. Kur u ardhë Azemi për me na

folë qysh duhet me vazhdu studimet e ligjeratat e mos me bo grevë, i kom thanë, “Ik se ti je tradhëtar i kombit”, se qysh nga Kamenica, Dardana, njifemi me to. Thashë, “Ti”, thashë, “je dorë e shkaut, ti je tradhëtar, me ty s’bisedohet”. Bile, tash njani tha, “Çudi që s’të ka qit kur i ke thanë tradhëtar”. Tani e kemi pasë ni polemikë me të. Ai e pranon se më ka thanë Sami Dërmaku tradhëtar, Haqif Mulliqi e ka bo... osht’ ni shfaqje. Dje e pashë qaty e kisha intervistën. Ata e ka vlu Komiteti t’u diferencu, t’u shku...

Anita Susuri: Ju thatë që edhe ju kanë marrë në ushtri për këtë arsye domethonë se ndoshta ju kanë identifiku si problem potencial që nëse bohet përvjetori apo? A keni qenë?

Sami Dërmaku: Po, po de. Ata kanë pasë frikë mos po protestohet në vigjilje të përvjetorit, 27 nëndorit.

Anita Susuri: Në ushtri në cilin vend keni shku?

Sami Dërmaku: O për besë në Bosnje, kom harru cilin se s’kom nejtë shumë aty, më doket, s’e di as... osht’ ai qyteti që ka shkru Ivo Andriqi “Na Drini Čuprija” [srb.: Ura mbi Drin]. Nuk e di, e kam harru. Bile, bash ni ditë thashë duhet ta shikoj se e kom edhe librezën e lëshimit. Po, po harrohen gjërat, është interesant. Tash kemi fillu...

Anita Susuri: Jo, s’osht’ problem. Jo, veç deshta me ditë a keni pasë edhe atje për shembull biseda informative ose diçka?

Sami Dërmaku: Jo, jo. Jo, jo. Ata s’kanë pasë dokumente për mu derisa... kur ka mrri dokumenti unë kom ardhë.

Anita Susuri: Dhe nuk jeni kthy ma pastaj?

Sami Dërmaku: Jo, jo, i paaftë. Edhe i paaftë edhe me gjetë nuse.

Anita Susuri: A keni vazhdu me aktivitetin?

Sami Dërmaku: Po, aktivitetin e kom vazhdu pasi jom dalë prej ushtrie. Domethonë, atëherë ‘70-ën me Rexhep Malën, Isa Kastratin edhe Ferdeze Muja edhe unë kemi dalë në Shqipëri...

Anita Susuri: ‘70-ten.

Sami Dërmaku: ‘70-ten. Edhe atje na kanë pritë me synim që të ktheheni mos ta jepni shembullin se zbrazet, Kosova ka nevojë për juve. Kurse ne kemi arsyetua se ne kemi dalë në kada ushtarake që ni ditë m’u kthy në Kosovë që kur e kërkon nevoja.

Anita Susuri: E në Shqipëri qysh keni dalë? A ka qenë ilegalisht a?

Sami Dërmaku: Tashti, meqenëse ne Rexhep Mala, Isa Kastrati dhe unë kemi qenë tre shokë të pandashëm, tash për të mos na marrë që kemi dalë bashkë, llogaritej sikur jemi në celulë treshe. Atëherë unë kom dalë me këtë vajzën, në Dardani e ka atë barnatoren, Ferdeze Mujën. Ai ka dalë me Rexhep Malën. Po plani ka qenë që të tret të dalim për të njejtën kohë. Pastaj kemi shku në Beograd te tret, në ambasadë për m'u furnizu me literaturë e me materiale tjera edhe me marrë instruksione tjera. Kur ka ardhë Titoja në Gjilan, jo në Gjilan po në Kosovë, s'e di farë viti ka qenë, po hera fundit më duket ka qenë, '73, po. Mu, Isa Kastratin edhe Rexhep Malën na kanë fut në burg derisa u largu Titoja prej Kosovës. Po paraprakisht që mos po bojmi na naj, po. Nja ni javë e diçka, ndoshta dy javë. Po prapë...

Anita Susuri: Ni javë, a dy ju kanë majtë?

Sami Dërmaku: Po de, na kanë majtë të izolum. Bile, ka qenë në Rozë Devaja, "Rrnoftë Tita, poshtë ky, rrnoftë Todor Zhivkovi, rrnoftë..." (qeshë). Shaj Titën, shaj Enverin, i çmendur, tanë kohën t'u bërtitë. Por jom frikësu që po del Rozë Devaja po bon ndonjë parollë.

Anita Susuri: Po. Shumë po më intereson qikjo në Shqipni qysh keni mujtë me kalu se ka qenë shumë strikte mos me dalë?

Sami Dërmaku: Jo, unë i kom pasë do shokë të Gjakovës, të Junikut. E përmes tyre, prej Gjakovës shifej thanë, "Qaty duhej me dalë", që ish ma e përshtatshme. Ishte kështu si lug, mes dy kodrave. Mirëpo, kur dolëm që e pata marrë vesh që kemi dalë, ishte pjesa e kufirit, zona neutrale që thojnë, e lavrume, e rrafshume që kur të dalim me i pa trajqit që ka hy armiku, po. Po interesant na patëm lexu shumë. Ishim frymëzu, nana Shqipni, propaganda, fjaltë edhe ne lexo, kqyr filma. Po s'ish konë qashtu, jo, s'ish konë qashtu. Bile më kujtohet, se nashta, a i thojnë asaj Ferdezës, "A u gdhive?" Ajo e kuptojke ndryshe. Thojke, "Çka po të rrok zori ty?" (qeshë).

Anita Susuri: E qysh ju duk juve ai vendi ose njerëzit?

Sami Dërmaku: Po shiko, tash kur ta shikojsh se qysh ka fillu Shqipëria, qysh u konë e Ahmet Zogut, vërtetë ka bo shumë për themelimin dhe fomimin e Shqipnisë, ka qenë e shkatërrume krejt. Prej hiçit e kanë nisë. Arsimin e kanë pasë në nivel, artin e kanë pasë në nivel, folklorin. Varfëri ka pasë. Unë, na ishim, patëm shku merre mend ajo Ferdezja me ni fund tamon si perëndimi, ato të shkretat me do tesha veshun. "Shif mor, shif, po flasin shqip more kta?" "Po shqiptar more jemi". "Jo nga jeni?" "Nga Kosova". "Po Kosova a osht' qytet i madh a?" Të ndalume. "Si more qytet i madh", i thojsha, "sa gjysa e Shqipërisë oj zojë". "Po si flisni në shpi ju? Shqip?" Kanë qenë automatikisht çashtja e mbyllur. Kanë shkru ndonjë artikull, ndonjë diçka, përndryshe s'ipej. Po vend i mrekullueshëm megjithatë. E tash çka

ka bo, me kazma e me shatnoj. Bërja e tarracave të mbjellura me ullinjë ose me prodhime tjera bujqësore çka munden me përdorë.

Anita Susuri: Sa ju ka ra me nejt atje?

Sami Dërmaku: Po vallai nja dy muj ditë. Afërsisht dy muj, ni muj e gjysë, dy muj.

Anita Susuri: A keni pasë ku me qëndru?

Sami Dërmaku: Në kamp kam qenë, në kamp. Edhe ai ka qenë ni lloj kampi, por ne kemi qenë mbyllë.

Anita Susuri: A po a?

Sami Dërmaku: Po, po. Veç ditët e fundit të kanë marrë, të kanë qit' në Tiranë, në Durrës, çka po di unë. Jo, jo {shpjegon me duar që mbyllë kanë qenë}.

Anita Susuri: Çka u konë kjo? Si lloj organizimi, a çka ka qenë?

Sami Dërmaku: Po tregova, po tash, dëgjo, po thotë ni shok në intervistë që e kam marrë me Haqif Mulliqin, “Pse dole në Zvicërr?” Thashë, “Haqif”, thashë, “dy herë në burg për vepër penale. Ni herë në grupin e Adem Demaçit gjashtë vjet i dënum. Niherë tjetër dy vjet”. Se tash kur dola prej Shqipnijës më thanë, “Dërmak”, se më bonën pyetje... mas Shqipnisë masi dola për do material që e kishin nda, mu te dy herët shoktë e organizatës, të ilegalës më kanë qitë, se s’po du me ia përmend emrin. Kur dola prej Shqiprijës, erdha prej Shqipërijës, se nuk të majnë ni muj apo dy muj ditë burg kalimtar për kundravajtje. Unë s’po pranoj kurgjo.

E tash nifarë Bleki ka qenë, si duket i Mitrovicës, Blerim e ka pasë po Bleki i thojshin. [Ai] Tha, “Kqyre Dërmak, disa herë për kundravajtje”, se edhe në ‘85-tën kom dalë në Shqipëri, masanej po për tjetër arsye. “Disa herë për kundravajtje, dy herë vepër penale armiqësore je dënu, dy herë ke dalë në Shqipëri, na e dijmë pse ke dalë. Qito me t’i numëru dhjetë vjet burg i han. Je i papërmirësueshëm”. E tash, ky Haqifi që e bona intervistë ma bon këtë pyetje. I thashë, “Po pa bo kurgjo hiç...” se më thanë, “Ti grahi, nëse ta qet’ ty, ti grahi anena, na i grahim knena. Ti vazhdo”, thashë, “ai më lajmëroi që dhjetë vjet m’i japin burg pa bo kurgjo hiç, e me bo diçka”, thashë. “Tana unë me hi në burg, çfarë kontributi muj me dhanë? Kështu kur jom dalë në Zvicërr kom bo aktivitete”.

Nantë milion e 700 mijë franga pare janë mbledhë, i kom faturat krejt që janë ardhë në emër tim. I janë dhanë Bujar Bukoshit. Thashë, “Kom organizu mërgatën, kom mbledhë pare, kom qenë kryetar i Bashkësisë së Klubeve dhe Shoqatave në Zvicërr, themelues i LDK-së, organizator i “Tre përqind” në nivel të Zvicrrës. Kryetar i shoqatës që u bo e Prishtinës në Gjenevë. Kom organizu protestat, grevat e urisë. Dy greva të urisë i kom organizu t’u nejtë para Kombeve të Bashkume”, thashë, “bile e kom

dhanë ni kontribut”, thashë, “jo bile me shku në burg tashi edhe ma s’pari nuk e din a del i gjallë, a s’del i gjallë edhe sado peripeti të jetë. Mandej edhe familja tanë kohën t’u ecë nëpër burgje t’u na vizitu”.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Cila ka qenë arsyeja edhe qysh ndodhi arrestimi i parë?

Sami Dërmaku: Arrestimi i parë a? Shoku i celulës më ka qit. Kur më ka thanë Osman Dumoshi se ka ra filani në burg, e kom ditë që s’ka me më shku gjatë...

Anita Susuri: Keni dyshu?

Sami Dërmaku: Po. Mandej, ajo ka qenë ni inskenim shumë i poshtër, se Kadri Osmani ka banu te unë, ka majtë katër vjet burg, s’e di a ke dëgjju për to?

Anita Susuri: Po.

Sami Dërmaku: Edhe u lidh me ni njeri që unë e njifsha ma mirë se ai, po ai propozoi edhe nuk desha me ia prishë. Me qëto që më ka qit jom shku ni herë a dy herë me pa vendin ku duhej me marrë atë [shaptilografin]. Ai s’ia majke me majtë, u frigojke. Unë kap e kapi, se isha student i Fakultetit Teknik, nëse më shohin që e kom në dorë po i thom p’e çoj prej kësaj hapësire në hapësirën tjetër. Objekte të ndame kanë qenë. E gjej ni thes, e futi në ta edhe ia jap Kadriut. Tani ky tregon që jemi konë me Sami Dërmakun me pa vendin për me rrëmby shaptilografin.

“Jo”, thashë, “ai kollaj e ka”, thashë, “me më thanë mu. Unë student i elektros po dojsha me vjedhë”, thashë, “ku shërbehen studentët. Masi paska qenë qasi soji, ai e paska marrë”. Qishtu. Shiko, nuk ke pasë, UDB-ja po shumë e kuadro ka pagu për me të pëcjellë, me pare e pa pare në emër të Vllaznim-Bashkimit. Kush ka qenë me regjimin ka jetu si peshku në vjam. Po jo ata që kanë vepru e i kanë përndjekë edhe familjen. Mu baba më thojnë kur ka vdekë, rreth e rreth UDB-ashët t’u e përcjellë funeralin. Gjyshja po ashtu. Unë, asnjë s’e kom pa.

Anita Susuri: Kur keni qenë ju kur jeni arrestu edhe a e keni, po mendoj, ju e paskit pritë arrestimin?

Sami Dërmaku: Ë?

Anita Susuri: Ku keni qenë?

Sami Dërmaku: Qitu në Prishtinë, në Prishtinë.

Anita Susuri: Në banesë?

Sami Dërmaku: Në shpi se shpinë tonë e kemi pasë, po.

Anita Susuri: Kanë ardhë aty?

Sami Dërmaku: Po, po, si bisha, si hijena. *Bum, bum, bum* {onomotope}. Ajo nona, “Dreqi ju hongët, s’na lat kurrë rahat” (qeshë).

Anita Susuri: Po ju nifarë forme e paskit pritë që keni me u...

Sami Dërmaku: Po, po. Po unë tash mendojsha, me dalë jashtë, unë qit’ duhan tetë vjet burg janë bo që i kom majtë. Kurrë s’e kom pi në burg. Kur jom dalë apet e kom dhezë, sepse nuk e dijsa. Tana këto e ke pasë ni armik edhe je dashtë me qëndru. Mos m’u korit para shokve, po ballë për ballë me armikun. S’ma merrke menja me dalë. Tana edhe herën e dytë kur më dënunë dy vjet edhe masanej thirrjet në biseda...

Anita Susuri: E kjo hera e parë, burgosja, a ka qenë me grupin e Adem Demaçit a?

Sami Dërmaku: Po, po, me grupin e Adem Demaçit isha.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë dënimet që ju kanë dhanë grupit për shembull? Maksimalet. Maksimalen e ka pasë?

Sami Dërmaku: Baca Adem, po, baca Adem nantë vjet. Rexhep Mala... qaty se kom harru. Shtatë e tetë...

Anita Susuri: E juve sa ju kanë dënu?

Sami Dërmaku: Unë gjashtë, Isa Kastrati gjashtë, Rexhep Mala nantë, Xhavit Demaku tetë a nantë, Hasani po ashtu. Kanë qenë dënime drakonike. Qëllimi ka qenë me tregu që qe qysh e luftojmë na armikun. Ka qenë inskenim ajo. Ajo ni kohë gjatë u majtë, kanë ardhë dokumente që duke ditë që Kadri Osmani, se ishte burgosë Kadri Osmani aty, ka banu te une. “Te ti u majt”, thojke, “kuvendi për themelimin e Fondit Nacional-çlirimtar”. E mandej e kanë qit te Skender Kastrati. Bile, unë i kom pasë nja dy vet në ballafaqim, se bohet me i bo njerëzit asht e lëkurë prej torturave. Më thojshin për mu, “Skender Kastrati ka qenë kuq si gjaku po bardh li letra e kemi bo. Ti hala i kuq je”. E kur e kom pa këtë tjetrin se çfare e kishin bo, më shkun lot. “Isuf Karagurushi, ki ni zor të madh që m’dul ky në ballafaqim”, thashë, “Po zor të madh kom o kriminela, kqyr çka i keni bo njerit”. “Sa torturen ta kemi dhanë ti s’ke kajtë, tashti po qan”. Prej dajakit më bjen të fikt mu, shtriye për toke, me bakall të ujit ta kthen shpirtin.

Anita Susuri: Edhe prapë?

Sami Dërmaku: Po, po.

Anita Susuri: Këto herën e parë kur jeni burgosë, ku e keni mbajtur dënimin? Në cilat burgje?

Sami Dërmaku: Në Prishtinë, në Pejë, në Zenicë, Sarajevë. Bile ,në Zenicë kemi qenë me Rexhep Malën kemi qenë, [Agim Sylejmanin](#) e të tjerë. E kur më çun në Burgun Qendror të Sarajevës, CZ që i thojnë *Centralni zatvor* [Burgu qendror] edhe aty m'fusin me ni qeli që kishte pasë ni hallkë në mes. A mu m'pat' rre stomaku se isha në grevë urie. Ata t'u i lidhë njani në do sinxhirë dur të me kamë edhe me nejt qashtu. Hallkë të rrumbullakët. Bile po m'thojnë tha, "Ktu a din kush ka qenë?" Thashë, "P'e di, Skender Kastrati". Vazhdova në burgun e tij. E tash burgun e dytë në Prishtinë, Gjyarak, Prizren. Bile bojsha probleme unë kështu me... bile në burgun e dytë ka qenë Shaqir Shaqiri, Kadri Rexha edhe Muhamet, Muhamet, historiani...

Anita Susuri: S'ka rëndësi. Nëse s'ju kujtohet osht' në rregull. Po mu po më intereson për Burgun e Prishtinës. Si kanë qenë kushtet? Si ka qenë?

Sami Dërmaku: Tmerr ka qenë. Tmerr ka qenë. Ni si krevet të drunit, do shipke, do... të errta dhomat, veç vrimat ndërmjet...

Anita Susuri: Grilave.

Sami Dërmaku: Hekurave. Veç me vrima, me kalu kohën me i numëru para, majtas, djathtas, qishtu. Torturat kanë qenë të tmerrshme. Edhe çka osht' ma keq, po ta tregoj rastin në burgun e dytë. Më merrte në pyetje, qysh thonte ai, që ka qenë kryeshefi kryesor i UDB-së së Beogradit. Një ka qenë i Banja Llukës, një ka qenë i Titogradit. Tani unë kisha marrë ni, prej, Hidajete Osmani ni grumbull materiale të Partisë Komuniste të Avdullah Prapashticës. Nejse tash ato zihen edhe zihen te Hidajeti. Po Hidajeti ka qenë i torturum katastrofiksht. Dalin që materialet kanë rrjedhë prej meje. Nja ni muj më kanë marrë në pyetje ata.

Bile tha, "Qysh po bisedojmë?" Jo, "E para punë, çka po don me pi?" Thashë, "Unë s'pi kurgjo", "Qysh", tha, "s'pin kurgjo? Kafe?" "Jo, jo", "Koka-kollë?" "S'pij bre", thashë, "Pse s'pin?" "Unë nuk pi", thashë, "me armik kafe", thashë, "unë pi me miq", thashë, "ti don me ma bo vorrin mu, e po pi unë me ty kafe," edhe met. Hajt, hajt, hajt më murr në pyetje edhe dikur kështu... po në fillim prapë pas kafës, "Qysh po bisedojmë?" Thashë, "Unë shqip flas ma mirë, shpjegoj ma mirë". "Po ti", tha, "p'e dishe serbishtën mirë", "Unë serbishten e di, po ma mirë e di shqipen", thashë. "A din çka", tha, "po flasim serbisht mos të marrin vesh ata tut", domethonë, kta ma burra të mirë se ata. Po prapë s'ju besojshin atyne, pavarësisht.

Në fund tha, “Hera e fundit që po të thirrim e mendo mirë”, tha, “e mandej”, tha, “ti ruju”. Thashë, “A përfundoi?” “Në rregull”. “Dëgjo”, tha, “na me ty”, tha, “s’mujmë me vazhdu kësi soji. Se na ka thanë fol me të”, edhe po i bjen murit me dorë, “fol me murin. Po a din çka”, tha, “të çojmë te ata tut, ti e din çka të bojnë”. Këtë du me thanë, ma kriminela kanë qenë shqiptartë, shërbëtorët, se shkijet. Se ata u deshtë me dhonë prova që janë përbetu për ta vazhdu krimin e tërbuar. Unë e kisha lanë ni vajzë në Gjenevë, Vlorën... Muharrem Dana, “Ha biri jem, a ke hangër? Çka të ka qit’ nana? Çka të ka bo kështu?” Që me më vra mu, se ti ke lanë ni vajzë jetime tash ka mbetë kërkund hiç. Torturat në mënyrë mizore i kanë bo, ma zi se shkitë.

Anita Susuri: Burgun e parë sa ju ka ra me mbajtë? A ju ka ra krejt apo ju kanë liru?

Sami Dërmaku: Ni vjet ma kanë hjekë. Gjashtë vjet jom dënu, pesë [i kom mbajt].

Anita Susuri: Gjatë burgut të parë dhuna a ka qenë veç gjatë kohës kur janë bo hetimet apo ka vazhdu edhe ma gjatë?

Sami Dërmaku: Jo, hetimet kanë zgjatë pesë-gjashtë muj e masanej kur e kanë pa që ma s’kanë çka nxjerrin... tana gjygji ka qenë ni formë formale se përndryshe komiteti ka vendosë, UDB-ja kavendosë kush, sa, tek dënohen.

Anita Susuri: E ndërkohë sa keni qenë në burg a keni mujtë me lexu literaturë ose me pasë?

Sami Dërmaku: Jo. Sa kemi qenë në Prishtinë gjatë hetimeve s’kemi pasë kurgjo hiç, as gazeta, as kurgjo. Kur kanë përfundu hetimet kanë fillu mandej gazetën me marrë për me lexu. E në, tana prej Burgut të Prishtinës mu më çun në Burgun e Pejës. Aty ka qenë ni drejtor i mrekullueshëm, Fuad Kryeziu, vllau i Ekrem Kryeziut. Atëherë merrshim literaturë. Ai kur erdh baba me vajzën e vogël timen, Vlorën, s’i kishte ajo tre-katër vjet, pesë. Vike ajo, “Babushi, babushi” edhe më qafke. Baba, “E bërllogu, as s’po din reni kur osht’, qysh me folë, po çikën me përqaftë”. Thashë, “E more babë, ti nuk e din çka osht’ evladi”. Tha, “Po unë për kond jom? (qeshë) Për kond jom ardhë?”

Anita Susuri: E sa shpesh i keni pasë vizitat?

Sami Dërmaku: A?

Anita Susuri: Sa shpesh i keni pasë vizitat për shembull?

Sami Dërmaku: Në mujt, në mujt. Kur erdh vajza shkoj deri te maqina aty me prekë. “Ik”, thashë, “se babushi për qita dënohet. S’bon”. Ai Fuadi e nxorri ni grusht kështu pare të ima, kështu të hekrit e ia dha. Thashë, “A”, thashë, “drejtor kot e ki”, thashë, “s’mun e korrupton vajzën time ti”.

Anita Susuri: Domethonë, keni has në përkrahje prej ktyne?

Sami Dërmaku: Po thom kah kom shku greva kom organizu. Tash ta jep ni libër që shkrun shoku për mu. Kom organizu greva.

Anita Susuri: Sa kanë qenë grevat për shembull?

Sami Dërmaku: Burgun e Shtimës ishin këta intelektualët që janë dënu, Ukshin Hotin, këta të Pozharanit, ia harrova emrin. Domethonë, grupi i intelektualëve. Ky Geci, e te une, te na erdh në dhomë tonë Mentor Kaqi, i Gjakovës. Unë p'i thom Mentorit, "Hajde organizohemi". Hidajetin e patën torturu s'un e patën qit në gjygj. Po ni muj ma vonë e kanë dënu fill vet, jo me shokë. Për shkak të torturave që ia kanë bo Hidajetit. Unë e lo ni letër, e shkruj ni letër, e nxjerr këtë prizën e dritës edhe e shti mrena tana e vendosi aty. Tash i thom shokve, "Qaty e keni ata, merrne lexone", që të përcillet tani, dhomë pas dhome. Tash ni idiot aty, s'po ia përmendi emrin, shkon e len letrën në derë të tualetit.

Po tash, pse p'e mshefi ato fort që kërkujt s'i kish shku menja ku e kom lonë, ti p'e qet' në derë të tualetit. Isha t'u u rru, ni polic ka qenë i mirë bojke hajgare, i pata lshu musteqet. "Amon, amon, tre rena musteqe, tre rena kime ti po lshon musteqe", se s'kisha, të rralla [i kisha]. Kur t'u u qethë e t'u u rregullu, berberi, "Hajde, po të thirrin naltë". "Haj medet", thashë, "çka ka plasë". Kur shkoj, "Ti le që s'po na le rahat jashtë, po edhe mrena s'po na le rahat". Thashë, "Jo, s'kom..." se unë e pata qky atë gazetën, atë pjesën e bardhë të "Rilindjes" e pata lonë... bohet, s'bohet. Thashë, "Jo, jo, s'u bo kurgjo, çka keni me..." "Kqyre bre", tha, "edhe pse je armik, bile pak i sinqertë duhesh me qenë", thashë, "Unë nuk kom çka me qenë i sinqertë".

Kur e nxorri prej fijkës ata, ata që e kisha shkru une. "E qita?" "Qita", thashë, "unë e kom shkru", se e disha që ata shkojnë e verifikojnë me kaliografi aty. "A osht' shkrimi yt?" Se kishim me dhanë edhe deklarata me shkrim. Thashë, "I jemi osht". Mos me pranu muj m'i nxjerrë telashe tjerëve. "Po i jemi osht". "Ku e ke lonë?" Unë tash s'pe di ku e ka marrë ai. P'i tregoj ku e kom lonë, u çuditën. "Te ndërprerësi", thashë, "e kom nxjerrë edhe e kom lonë". Aty shkrujsha që ta organizojmë grevën. "Dëgjo, çka po të thom", tha, "mos gabo ti me pasë punë", "Se unë grevën e ndërprej", thashë, "Ti bo çka të dush, tek e fundit". Edhe e vazhdova grevën. Më patën ardhë në vizitë, s'e di më duket, s'ju pata dalë në vizitë atyne se isha në grevë edhe kështu. Tani pasi më çunë prej aty, më çunë në Gjyrakoc. Tash isha i burgosun i vjetër ma, krejt t'u i marrë...

Anita Susuri: Kjo ishte gjatë burgut të dytë?

Sami Dërmaku: Po, gjatë burgut të dytë tash po të tregoj. Pasi...

Anita Susuri: E po më intereson diçka...

Sami Dërmaku: E prej Burgut të Pejës tash, Fuadi më thotë, “Dërmak, kanë me të çu me ni burg të keq. Ruju, ki kujdes se nuk e ki Kryeziun drejtor atje dhe mund ta kurdisin vrasjen. Qysh ke vepru këtu...” Mirëpo, jo, s’ka qenë kumeditë çka, se kemi bo edhe atje greva. Ka qenë Rexhep Mala, përpara ka qenë [Binak Ulaj](#), ai ka shku ma herët. Prej Burgut të Pejës, po mendoj prej Prishtinës në Gjyrakoc isha një ndër ma të vjetrit, si i burgosur politik, se kishte edhe ma të vjetër kështu me moshë. Erdh sekretari Enver Limani, se sa isha në Prishtinë ai vinte te qelia ime, e çeli ata edhe u rrokëm me të. Si duket Sadi Nimanin e ka pasë vlla, unë kom qenë në Burgun e Pejës me ta, paraprakisht në burgun e parë. E sigurisht i ka tregu për mu edhe u rrokëm me të tani më tha, “Ishalla sytë s’ti shoh”. “Edhe unë hiç mos t’i pafsha sytë”.

E kur shkum në Gjyrakoc tash krejt që na mblodhën rreth e rreth ish bo. Unë qaty bile e kisha ni fanellë të leshtë nana ma kish bo. Tha, “Kqyrni”, tha, “djema”, tha, “për mos me ju çu nëpër burgje të Serbisë na e kemi hapë këtë burg këtu. Po nëse vazhdoni si Sami Dërmaku”, tha, “krejtve kanë me ju shpërnda”. Unë edhe po keshi. “Çka po kesh?” Thashë, “Valla, tash regjimet lavdohen sa fabrika kanë çelë, sa spitale kanë bo, sa shkolla i kanë bo. M’u krenu që keni bo burg ju këtu”, met ai. “E ti”, tha, “çka kishe bo me kanë në vend temin?” Unë krytë përpjetë. Tha, “A më kishe çu te Zoti a?” Thashë, “Po vallahi” (qeshë).

Anita Susuri: E Gjyrakoci çfarë burgu ka qenë?

Sami Dërmaku: Mirë ka qenë. Gjyrakoc ka qenë, mirë ka qenë. Mujshim me dalë shëtitje krejt s’bashku. Ka qenë ni restaurant u ulshim. Bile, tana ma...

Anita Susuri: Mrena burgut a?

Sami Dërmaku: Po, po. Ka qenë ni restaurant aty. Bile, ka vdekë edhe baba edhe Xhevdet Sylja. Ai shumë ni djalë i mrekullueshëm ka qenë. Babën e tij e kom pasë msus në Shipashnicë. Ai ka qenë në celulë me ni Zymrytën që u dënu. Se ajo grua e tij, ajo Gashi, s’e di qysh e ka pasë emrin, s’e di a e ke marrë në pyetje, a ke bisedu me të a jo? Jo? Mos e le pa bisedu me të, me Zymrytën, ta gjej, po. Edhe grua e tij ka qenë, qysh e pat’ emrin, Gashi mbiemrin, edhe ajo në burg ka qenë. Ai kur vjen nana, baba i qesin atë Xhevdetin në vizitë edhe i tregon Xhevdeti që edhe Sami Dërmaku osht’ këtu. Kur del ajo, e kryen vizitën. Ai baba i vet thotë, “Çka? Me Sami Dërmakun koka bo a? S’paskemi ma djalë” (qeshë).

Anita Susuri: E prej Burgut të Gjyrakocit, po më vjen shumë çudi që paska pasë edhe kafe...

Sami Dërmaku: Po, po, çaj e kafe e këto. Po se unë, se tashti t’u hypë përpjetë na në... u ndajshim me shokët që ishin në katin përdhesë edhe na që ishim në katin e epërm. Unë me grusht t’u bo edhe t’u u përshëndet me ta. Vjen ni gardian i poshtër shqiptar tha, “Hiqe atë dorë”, tha, “se ta kputi”. “Hajde kpute. Kjo osht’ dorë shqiptari”, thashë, “unë nuk kam dorë shkau”, thashë. Tani prej atyhit, “Zbrit

poshtë!” Unë nuk bijsha niherë. E disha që po ju nxjerrë telashe atyne, rash, u rroka me të. Mirëpo, më futën në qeli. Ni qeli kështu krejt në beton. Marrin vesh kta që... edhe shpalla grevë, krejt burgu shpalli grevë. Bile edhe [ata që ishin për] vrasjet e hajnat e... Dalin të burgosurit, shoktë në grevë nuk hajnë, nuk pijnë, nuk marrin asgjë. Bile i bojnë shantazh as ujë nuk i japin. Erdh puna, unë e disha që si faktor i grevave edhe pse disa ashtu i kanë... thashë, “Unë e thej grevën, e ndërprej grevën me ni kusht me marrë me lexu”. Si të kisha me lexu, unë s’e kisha gajlen edhe ni muj me më majt. Tha, “Ani p’e plotësojmë kushtin”.

Tash po i thom atij, Bujupi e ka pasë mbiemrin, atij Bujupit i thashë, “A din pse ju keni fillu me mu me burgosje me qelia?” Thashë, “Sepse jom ma i vjetri e t’u mendu çka po më boni mu, ata të rit tash me ju dhanë mësim [tjerëve] çka ju gjon. Po ta kallxoj ni rast”, thashë, “ni vajzë e kish veshë fustanin, ni fustan të mirë të ngjyrosun. Ni shitës habitet ashtu, e pa atë vajzën hin ia vjedhin shitorën. Tash shkojnë e kapin shitësin, ‘Qysh ta vjedhën shitorën’, tha, ‘Vallahi ni vajzë i bukur ke edhe ni fustan të bukur u habita t’u e kqyrë edhe hinën ma morën.’ Shkojnë e zojnë atë vajzën, ‘Pse ti e ke ngjyrosë fustanin kaq mirë e je bo se bep osht’ vjedhë shitorja?’ ‘More’ thotë, ‘cila shitore? Po unë jam vajzë, si të mos veshëm bukur, mirë qysh marrë vëmendje që dikush më pëlqen mu’, thanë, ‘Po mirë mirë po kush ta ka bo ngjyrosjen? Filan bojaxhia. Shkojnë te ai bojaxhia që me vjerrë. E qesin litarin, s’un p’e vjerrin se kamtë në tokë po i bijnë. Po i thotë polici, policit, ‘Le, le kta ai bojaxhia ma naltë e ka tavanin mujna me vjerrë’”. Ai po më thotë mu, “Hasa edhe Hysa ishin dalë, njani me vjedhë. Hysa me vjedhë, Hasa me rujtë. Kur kalojnë policia, ‘Çka po bon?’ Se e kanë ditë që hajn osht’ s’ka dalë për të mirë. Tha, ‘Jo’, tha, ‘jem poet, po frymëzohem’. Qielli i kaltërt, vetura e kaltërt ruju Hasë se të zuni e zeza...”

Anita Susuri: Me ia çu atij...

Sami Dërmaku: Po, “Ai e murrë vesh”, tha, “ai iku e shpëtunë”. Po mu me kta më tregojke që hi gjak. Se unë vnova kusht, polici që më ka kërcënu mos me qenë aty. Tana kur dola unë t’u bo rrethi thu ti që për herë të parë po shkoj edhe t’u ju thonë atyne, “Sami Dërmaku na ka majtë, se mos me kanë Sami Dërmaku e kishim kallë”. “Jo”, thashë, “mu ma kishit prishë punën”, thashë, “se unë ktu s’jom ma”, “Pse?” “Po nuk dojnë ata me pasë autoritet tjetër përveç autoritetit të burgut edhe qashtu ndodhi.

Tani prej aty në Prizren. E tash në Prizren tregoj, po më tregojnë do që kanë bo, tash kur shkova aty ai ka qenë Mufail e ka pasë emrin, ni zhurjan [nga fshati Zhur] drejtor. E kish nxjerrë atë librin, dosjen, “Ma i meçmi, ma trimi, ma agani”, “Dëgjo”, thashë, “ti mos më fol kush jom une, se unë e di vetën. Ti s’ki nevojë”, thashë, “me më thanë. Po unë du me ditë vetën a jom kalimtar, a jom i dënum?” Kalimtar të çojnë në burgje të hapta. “Varet”, tha, “prej teje”. Thashë, “Jo, s’varet prej meje. Unë i kom kry hetimet”.

Shpalla grevë urie 20 ditë. Po më thojnë, “Po ti”, drejtori, “në bisedë ia nisi atij tash ruje shëndetin”, “O zotëri”, thashë, “unë kom karakter e personalitet, s’muj me mbrojtë personalitetin tim përveç me protestë. Po ti”, thashë, “s’ki nevojë me”, thashë, “a më ke thirrë në bisedë?” “Po”, “Në bisedë jem të

barabartë”. “Çfarë bisede me ty i barabartë, unë drejtor, ti i burgosun”. “E”, thashë, “në qat’ vend ku je ulë ti, unë përpara preferoj burgun sesa m’u ulë qaty”. “Jashtë idiot!” T’më bërtiti, e t’më shanë (qeshë).

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: E burgun e dytë në cilin vit e keni mbajtur?

Sami Dërmaku: ‘82-‘83.

Anita Susuri: Sa keni qenë?

Sami Dërmaku: Dy vjet i dënum.

Anita Susuri: Çfarë aktakuze keni pasë?

Sami Dërmaku: A?

Anita Susuri: Çfarë aktakuze keni pasë?

Sami Dërmaku: Po qit’ punën e materialeve.

Anita Susuri: Qajo veç.

Sami Dërmaku: Qajo. Ajo bile... se mu dojshin me më bo, me më zanë si ndërlidhës mes SPK-së dhe Partisë Komuniste Socialiste Jugosllave të Avdullah Prapashticës. Po unë, s’e pata pranë kurgjo hiç. Bile, kur më kanë çu në gjyq, Shaqir Shaqiri, doktor Shaqir Shaqiri, a ke ndërgju? Kur u ktheva, kur murr vesh... se kur shkova në gjyq, bile ata policët, gardianët që ishin aty, “Dërmak”, thanë, “merre ni gajbe birra se shkoje”, demek.... E kur m’i dhanë dy vjet, ajo nana, “Kuku!” Thashë, “Hiç moj nanë mos u mërzit, se si ariu polar në gjumë i kaloj dy vjet” (qeshë).

Anita Susuri: Po duhet me ju pytë edhe për familjen e ju. Qysh i ka pritë qito? Qysh osht’ ballafaqu me këto...

Sami Dërmaku: Po ta tregoj se motra më ka tregu, nuk e di. Ajo nana kur më kanë shti në burgun e dytë, ka thanë Faik Nura, nanën e ka thirrë mrena, “A ka kush fol i folë Sami Dërmakut, se s’po na len rahat?” Thotë kjo nana, “Ma të mëçmin e kemi ata, nuk ka kush”. “Po a ka kush se s’po mahet?” “Mos u majtë”, tha, “lshone”, tha, “U dreqi”, tha, “ua hongër kryt”, tha ai Faik Nura. E kur më lshunë në burgun e parë, p’e bojmë zig-zage. M’u më thanë që duhesh m’u lajmëru në burg, në UDB-në në Prishtinë, vendi ku vijon. Unë nuk shkova. Vjen ky Avdullah Prapashtica me ni veturë të policisë edhe te dera

nalet. Po më thotë mu, “Pse”, tha, “s’je paraqit ktu?” “Mu”, thashë, “s’më ka thanë kërkush”. Më kishin thanë po s’dojsha, çka kisha me shku. “S’më ka thanë mu kërkush që të paraqitem. Unë e kom kry burgun”. “Jo, jo, duhet me ardhë”.

Kur shkova, aty Faik Nura. Po i thom, “O Faik Nura bre, të paska bo hajër UDB-a ty, je konë qishtu {shpjegon me duar për të dobët}, koke mush”, thashë, “koke bo burrë i...” edhe po thotë, “A e kryjte borxhin a?” Thashë, “Çka? Unë borxh juve? Jo, ju më keni borxh”, thashë. Thashë, “Edhe a din çka keni bo me këtë”, thashë, “kurgjo s’ju kom urrejtë përpara sa ju urrej tash, se jeni kriminel”, thashë, “e ti po më thu a e kryjte borxhin”. Bile, aty ka qenë Avdullah Prapashtica. Masi e ka bo grupin e vet ilegal tha, “Ke kah ma rreh në dur Sami Dërmaku” (qeshë). Po ai po hiperbolizon, a din. Po fjaltë që ia thashë nuk ishin për ta. E ma s’u kthy ai, ka dalë jashtë.

Anita Susuri: Deshta m’u ndërlidhë, osht’ ndërmjet ktyne mbajtjes të juve të burgjeve, janë demonstratat e vitit ‘81...

Sami Dërmaku: Kam qenë jashtë.

Anita Susuri: Qysh, qysh i keni përjetu ju këto?

Sami Dërmaku: Unë këtu me vajzën Vlorën pata shku, s’e di më doket ka pasë probleme dhomtë, te mjeku i dhomve. Aty te stadiumi që ka qenë përpara, s’e di a e mban mend tash a jo? S’e di a ekziston, qaty ka qenë. Edhe kur dola po i dëgjoj t’u bërtitë parolla, “Kushte, kushte, kushte”. Tash ne jse shkova qaty në kolonë deri te Fakulteti Filozofik, aty pastaj me vajzën shkum në kamë. “Kushte, kushte”, çka kushte? Po si duket ka qenë, ai spontan ka qenë, se përpara u thy ajo pjata me gjellë aty, domethonë kushtet e ushqimit. Thashë për ushqim... po masanej ajo murr kahjen e kundërt, të domosdoshme, të nevojshme. Bile, kur jom dalë në protestat e ‘81-tës masi u masivizunë ato, unë pata dalë me ni mantill. Ata kujto që jam UDB-ash, njoni kap ni guri me ma mshu mu. Tani ju tregon dikush, “Mo se sa ka dalë, osht’ i burgosun politik”.

Anita Susuri: A ka pasë shumë dhunë aty? A qysh e keni pa ju?

Sami Dërmaku: U vra djali i këtij Dacit, profesorit në fakultet të historisë. U pat’ vra ai djali tani ma anej me gurë e me t’u i gjujt policinë.

Anita Susuri: Kështu qyteti qysh ka qenë? Situata?

Sami Dërmaku: A?

Anita Susuri: Qyteti si osht’ dukë?

Sami Dërmaku: Qyteti nuk e di se s'kam qenë atje. Unë kam qenë kah Bregu i Diellit, kah menza atëherë që ishin ato, ato, po.

Anita Susuri: Po mas kësaj, domethonë masi janë bo këto ka fillu edhe procesi i diferencimit...

Sami Dërmaku: Po, po, po.

Anita Susuri: Këto ora policore e këto. Qysh ka qenë situata?

Sami Dërmaku: Azem Vllasi e ka thanë vet, "S'ka mesatare ose me neve ose kundër neve. Vi të mesme s'ka". Po shiko bre jemi, po a i ipet atij fjala bre me marrë me bisedu. Po bitjtë e komunistave i kanë këta televizora. Unë nuk e lëshoj, e kam mbyllë, u ndërpre. S'e shikoj fare televizorin. A e ke pa, si çakejë flasin. As nuk dihet kush po flet, as që po flet, as tek po flet.

Anita Susuri: Zoti Sami, që ishit t'u më tregu për burgun e dytë. Heren e fundit, domethonë herën e dytë kur keni dalë prej burgut, prej cilit burg keni dalë?

Sami Dërmaku: E tash në Sarajevë kur më çunë prej Zenicës, hina meniherë në grevë. Edhe masanej ndërkohë kur më hekën se ishin, thashë, ata kriminela, ajo qeli. M'i mbyllshin me kapak të metalit po barku më ishte prishë se isha në grevë, ishte trazu. Deri më zbritën poshtë unë isha në grevë. Nejse, kohë pas kohe erdh koha me më lshu. Ratko e ka pas u kon ni *načelnik* [kryesues], gati sa drejtori tha, "Dërmak", tha, "me qito menë ti ki me ardhë apet në burg". Kur na çunë prej [burgut] Pejës në Sarajevë, interesant, urrejtja në mes serbëve edhe muslimanëve, qaty e kom pa, e tmerrshme. Ma patën pru nifarë boshnjaki Mirza, "Vllasi⁸, vllasi, vllasi", "Kush janë bre vllasi?" Domethonë, ata vllahi i thojshin, a rumun, serbëve.

Anita Susuri: Aha, vllahë.

Sami Dërmaku: Vllahë. Burgun e dytë masi shkova i pata lshu musteqet, ai ka mujtë me marrë regjistrin me pa kush jom. Na bonën rend aty. Po ju thom unë dove, "Mos gaboni m'i shti fjaltë me gardianë, të sakatojnë". Krejt të qartun, nuk kom pa burg ma të tmerrshëm. Prapë burgun e dytë në Sarajevë unë. "A je", tha, "ti Sami Dërmaku?" Thashë, "Po". Tha, "A të kom thanë", tha, "që po të vazhdojsh qishtu ki me ardhë së dyti ktu?" Po thotë kështu i kom thanë ktina, "Po vazhdove kështu ki me ardhë [prapë] në këtë burg", tha, "ki me ardhë", tha, "edhe ju tjetër, po vazhdut rrugën e Sami Dërmakut keni me pësu sikur ai". Burgu i Sarajevës ka qenë i tmerrshëm ka qenë.

Anita Susuri: A ka pasë dhunë, a pse?

⁸ Vllah është emri që përdoret më shpesh për banorët e romanizuar të Ballkanit, pra folësit e gjuhëve romane lindore. Grupet kryesore të vllahëve janë dakorumunët (rumunët, moldavët), vllahët e Serbisë, arumunët, vllahët meglën dhe vllahët e Istrias.

Sami Dërmaku: Dhunë, dhunë. Ata nashta janë sjellë edhe kundër tjerëve, po dhuna në mes gardianëve boshnjakë, se kur vishin boshnjakë ka pasë ma pak, i rrehshin serbët. Kur vishin serbët i rrehshin boshnjakët, t'u piskat, t'u bërtitë.

Anita Susuri: Aty më duket që ka qenë si shumëkatësh?

Sami Dërmaku: Ku?

Anita Susuri: Në Sarajevë.

Sami Dërmaku: Po ku e kem pa, unë mrena sa kat.

Anita Susuri: Keni dalë prej Burgut të Sarajevës domethonë?

Sami Dërmaku: Po prej Burgut të Sarajevës herën e parë e herën e dytë.

Anita Susuri: E a keni dalë në qat' ditë për shembull? A ka ardhë dikush me ju marrë a qysh?

Sami Dërmaku: Po, po. Jo, unë i kom, me gjasë, i kom lypë teshat i kom lypë edhe ata krejt fëmija... vllau i dytë që e kom, i treti, i vogli, ai ka qenë në atë kohë gati se hala në moshë madhore. Nana ma... se në burgun e dytë... se baba niherë ka qenë në vizitë. E kish vnu ni plis të ri edhe nejse ai me shpresë që do të bohet amnestioni a çka po di une. Herën e parë, herën e dytë e mora lajmin që ka vdekë. E po i thom thashë, "A guxove", thashë, "me plis të bardhë me ardhë?" Tha, "Po me të kast e kom vnue, ishalla plasín" (qeshë).

Anita Susuri: A keni mujtë në varrim me shku?

Sami Dërmaku: Jo, jo. Familja e kishin lypë, po për ta thënë të drejtën unë nuk kisha shku. Nuk ia kisha bo qit' nderë që me thanë sa human janë kta. Unë i thashë nanës, se më tha, "Kemi lypë po s'të kanë lshu". Thashë, "Hiç mos ki gajle se s'kisha ardhë edhe me m'lshu".

Anita Susuri: Po ndërkohë, domethonë, pasi keni dalë prej burgut a keni mujtë me punu diçka a si keni mbijetë?

Sami Dërmaku: Tash ndëgjo, unë Fakultetin Teknik e kom regjistru në '68-ën. Domethonë, në vitin që kanë qenë demonstratat. Mu më pat' ardhë inati se e shajshin shtetin se e kisha marrë bursën prej Elektro-Kosovës. Qysh me ta dhanë armiku, me ta dhanë bursën? Tana ma bojshin hajnat, "Ju po doni me na rrxu. S'po muni me kry fakultet e po vazhdoni me na sulmu neve, m'u bo armiq, me na prish Vllaznim-Bashkimin", e tjera, e tjera. Kam ra në burg, kam majtë pesë vjet burg në Zenicë. Prandaj, në

fund prej Zenicës kam ardhë i kam vazhdu studimet. Kam ra prapë në burg pas sa viteve, prapë jom dalë, i kom vazhdu studimet. Domethonë, '84-tën kom përfundu studimet. 17 vjet gati, 15 a 17 sa?

Anita Susuri: Po.

Sami Dërmaku: Po me kusht se unë s'e kom shfrytëzu profesionin. Po me kusht me tregu që nuk osht' e vërtetë ju që thuni, po e vërteta osht' që luftojmë për ideal.

Anita Susuri: A keni pasë të drejtë me vazhdu, se dikujt edhe ia kanë ndalu krejt me u shkollu?

Sami Dërmaku: Po, jo unë isha... jo. Po gati shoktë e mi, kolegët e mi ishin bo profesora. Unë jom me Avni Dikën, ke dëgju, Isuf Krasniqin [e kom pasur] gjeneratë. Mandej Ruzhdi Sefën, kur dola pas burgut të dytë. Ishin njerëz tanë.

Anita Susuri: Pas burgut të dytë, a e vazhdat punën ju pastaj? A u punësutë dikund, a vazhdatë aktivitetin?

Sami Dërmaku: Jo, pas burgut të dytë më pranoi në punë Zaim Kurti, baba i Albinit. E mandej kur fillunë burgosjet, unë për mos me ra për herë të tretë dola ilegal. Pastaj prej ilegales dola shkova në Zvicërr.

Anita Susuri: A po? E çka keni punu aty te?

Sami Dërmaku: Ku në Zvicërr a?

Anita Susuri: Jo, te baba i...

Sami Dërmaku: Praktikën e kom kry si inxhinier, stazhin.

Anita Susuri: A veç stazhin.

Sami Dërmaku: Po veç stazhin. Mandej...

Anita Susuri: Cilin vit po i bjen që paskët dalë?

Sami Dërmaku: '80 e pak. Domethonë '81-shin janë bo demonstratat, unë para '81-shit demonstratat sa pata dalë prej burgut, po. Nuk ka pasë, s'e di nja dhetë-15 ditë a 20. Kom haru se janë bo... po për afërsisht.

Anita Susuri: E kur keni marrë vendim m'u largu, a ka qenë vështirë për juve? Po mendoj sigurisht ka qenë vështirë. Po qysh e keni marrë këtë vendim? Sigurisht ka qenë moment i veçantë.

Sami Dërmaku: Jo unë e thashë pak ma parë, kur ai [më tha], shumë e vërtetë ka qenë. Kur ai më tha, "Dy herë në Shqipni, dy herë për vepër penale, disa herë për kundërvajtje". Mandej, kur erdh Titoja na futën në izolim, ta quj izolim, ajo ishte qeli derisa shkoi ai. Dije që veç... unë thashë, e disha që me burg nuk jap kurfarë kontributi. Kështu, bile ma ka pa hajrin, bile familja s'jom bo barrë e tyre.

Anita Susuri: Në atë kohë a e keni pasë të formume familjen e juj?

Sami Dërmaku: Jo, jo. Në atë kohë, unë masi jom dalë me kto jom martu. Se me të parën u pata nda, nejse, telashet që kem pasë. E me këto masi jom shku... na u njoftëm me këto. P'i thom, "Kur dorën?" A din që thojnë teslimin. "Jo këtë javë, jo këtë javë", unë thashë, "Ani". Ndërkohë e pasha situata, dola ilegal, nejta te ni shok edhe dola për në Zvicërr. Kur tana këta mule, pyte ku osht' e tek osht'. Edhe mandej m'u lajmëru atje në Gjenevë me telefon. Thashë, "Deri në Lublanë e çoj njerin" (qeshë). Jashtë e kemi bo kunorën.

Anita Susuri: E kjo ka qenë në Kosovë, zonja?

Sami Dërmaku: Po de, zonja në Kosovë. Po, po.

Anita Susuri: E jeni bashku atje?

Sami Dërmaku: Po de, atje jemi bashku.

Anita Susuri: A ka qenë meniherë si keni dalë a mas disa viteve.

Sami Dërmaku: Jo, ka qenë mbas nja tre-katër mujve, pesë mujve qishtu.

Anita Susuri: E qysh u gjetët atje tash? Qysh vazhdoi aktiviteti juj atje në Gjenevë?

Sami Dërmaku: Në Gjenevë a? E para punë që jom shku... se unë jom shku në Shqipëri herën e dytë, se të tregova...

Anita Susuri: Po.

Sami Dërmaku: Na kur u mblidhëm disa shokë aty, ishte njëri me ma autoritet e ma i moshuar ishte Isa Kastrati. Sa kishte dalë prej burgut, vendosëm me çu Isa Kastratin... se atëherë '81-shi, u vranë Gërvallët, u vra gjendja në Shqipëri, u vra Kadri Zeka. Filloi mërgata të përçahet. Na i tham Skender Kastratit me shku në Shqipëri me marrë vesh me cilët persona mund të punojmë edhe me shku ti me

dalë m'u marrë vesh atje në Zvicërr. Po para se me shku atje, na provum këtu. Ishte Xhavit Haliti edhe ky i Maqedonisë, me flokë të bardha, qysh e pat' kryetari i atij... [Ali] Ahmeti mbiemrin. Kryetari i partisë ma të madhe të Maqedonisë bre që osht'...

Anita Susuri: Me më vra nuk po më kujtohet (qeshë).

Sami Dërmaku: E dreq o punë!

Anita Susuri: Nashta na kujtohet.

Sami Dërmaku: Nejse, e pata taku këtu te përmendoret pa dalë atje ilegal. Thashë, "Kështu kështu osht' problemi që duhet të ndërmarrim diçka me vepru", edhe Lëvizja pa adresë u pat' bo. "Jo valla, vendosin shoktë atje", në Zvicërr. Vendosa unë me dalë, mos me dalë Skenderi se Skenderi tha, "Po sa jom dalë prej burgut bre", tha, "ku me shku atje". Thashë, "Mirë", thashë, "unë po shkoj atje". E atje kom dalë nga Vuthaj, Binak Ulaj më ka qit' deri në kufi atje. "Tash", tha, "veç te poshtë". Bile, aty e pata pasë ni pistoletë të Rexhep Malës që ma pat' dhanë. Më ka mbetë në Shqipëri më ka mbetë duhet me provu me gjetë. Nëse e gjej, nëse ia ka lanë shenjë najkund. Tash unë bona gabim, por nuk e dishim.

Ata kanë dashtë me majtë nën prush [Kosovën], si thojnë prushin në hije, me nxe ka pak po mos m'u djegë. Mos me pasë shqiptartë e Kosovës punën në dorë vetë, po të jetë nën, ta quj, mbikqyrjen e Partisë të Punës. Kur, se shifej aty, edhe e mora vesh që po më kthejnë. Besa më pat' tregu Binak Ulaj si janë e çka janë ata, se kur të vinë me t'i marrë orën, unaza çka ki, e ta bijnë edhe pasaportën, domethonë po të kthejnë. Se unë i tregova, "Meqenëse keni Sigurimin, keni ambasadën, na tregoni me të cilët njerëz mund të bashkëpunojmë mos të na infiltrohen UDB-ashët". Se kah të jenë... rrugës t'u më pru te knej, unë s'po foli mo... Besa, sa isha atje tha, "A po na len pasaportin?" Thashë, "Ama pasaportin", [u mendova] ta marr ta çkyj, se e kisha të huj.

E mora e qita në WC thashë, "Merre". Edhe ia lash ni letër, "O zotëri, unë kom pasë kontakte me grupe, mos më ktheni se mund t'më japin drogë të çakordisin mendjen e ti flet sikur jerum, sikur zotni". "Duhesh me qëndru". "Po qysh me qëndru", thashë, "drogën ta jep me injeksion t'i lidh dur të, qysh munësh me qëndru?" Kur më qitën në kufi ia nisi tha, "Mos me kanë Partia, shoku Enver", tha, "Kosova", thashë, "Çka?" Thashë, "Çka po boni ju?" Thashë, "Ata me tenka e me aeroplana e ju po ia çoni maskën", thashë, "edhe unë po ta thom ty mos me qenë Kosova s'kish ma s'pari as shok Enver". "Qysh më thu kështu?" "Po, po, tash Enver Hoxha kur po bjen ngushtë po del në Tropojë po thotë Llap e Karadak çohen në kamë nëse sulmon kush Shqipërien". "Ti s'i beson Partisë?" "More unë po të thom çka po thotë Enver Hoxha. Llap e Karadak, çohemi në kamë me mbrojtë Shqipërijën".

Kur kom shku kom pa tmerr a, tmerr. Ato gra të qilitura me shati, me... teraca me çelë, kanale me çelë. E tash kur më qitën atje në kufi, erdhën policia serbe *trrak trrak* {onomotope} hallkat {shpjegon me duar vendosjen e prangave}. Po i boj atij, "Kqyre", thashë. E tash kur shkova në Gjenevë, ku ke

muhabeti. E para punë që kom bo kom rihapë Klubin “Igballe Prishtina” në Gjenevë e mandej kemi kry aktivitete. Pastaj, në themelimin e LDK-së jom një nga ata se shoktë, njana, “Hajde me neve”, se ka qenë lëvizja me adresë, lëvizja pa adresë. Tjetra, “Hajde me neve”, thashë, “Jo që e keni bo këtë gjellëhane ju”, thashë, “unë s’hi ma këtu pari me juve”.

Atë bashkimin që pretendova, ata e sabotun me mendjen e tyre se unë po shkoj... se kur ka shku Enver Hoxha i ka bashku grupet edhe e ka marrë pushtetin, a din. Se unë mos po ia boj si Enver Hoxha (qeshë) e po i boj bashkë me qenë vendi i parë. Thashë, “Jo more zotëri, aty mbahen një parë zgjedhje me njerëzit kryesorë të asaj, vendoset në këshill edhe vendosen kushtet e bashkimit. Del në kuvend kush e fiton e fiton. Nuk ka çka aty”. E mandej dul, dolëm me grupin komunist-revolucionar me organin “Jehona e Kosovës”, bile të gatshëm kanë qenë numrat m’i shtypë dhe masi dul LDK-ja [e para] i thashë atyre, “Maron kjo punë, ne duhet të punojmë në LDK”.

Bile kta shoktë që i kom pasë... se i kritikojsa këta të lëvizjes... se ti po del marksizëm-leninizëm midis shtetit ma kapitalist, po del me Enver Hoxhë, e me dreq e të birit të mallkum, po del te fotografia aty përpara. Kjo nuk ju nderon juve. Zvicra nuk, nuk ta ndalon po nuk të avancon, nuk të preferon me ra në kontakt me ndihmu me këta tjetër. “Pse ti me LDK?” Thashë, “Zotëri, ju që punoni me shokë të verifikum të celulave që kanë qenë dhe që kanë dhënë prova e keni ma lehtë. Unë e kom ma vështirë. Se këtë masë, këtë turmë që e keni nanat shqiptare i kanë lindë mor burrë shqiptar janë. Kush do m’i organizu? Kush duhet m’i pri? M’i lanë ashtu, ti as s’mun i falë as s’mun i shet. Shqiptarë janë”.

Tana nuk tregova pak ma herët, sa isha, e tash, domethonë kam udhëheq “Tre përqindshin” në kuadër të LDK-së, kom fakturat krejt ktu. Ndaqe ua tregoj. Mandej kom organizu shtabi për Vendlindja Thërret, me mbledhë pare. Pastaj, në saje të doktor Shaqir Shaqirit që kanë qenë sekretari ardhshëm i LDK-së osht’ bo Fondi Humanitar Gjithëkombëtar që e kom udhëheq edhe këtë. Domethonë, janë mbledhë nanë milionë e 700 mijë franga ju ka dorëzu qeverisë nga paret që janë mbledhë. Kam marrë pjesë në të gjitha grupet, se [LDK] kishte emër. Këta të LDK-së nuk donin për një kohë m’u bo unik, dojshin pavarësisht me qikaq sa kemi, tani le të mbetet emri LDK-ja p’i mbledhë.

Pasi u bo Fondi [Humanitar] Gjithëkombëtar edhe Lëvizja Popullore edhe të gjithë kanë marrë pjesë. Në javtë nga 20-30 mijë franga më vijshin faturat që në emën tim që janë qit’ nga banka. Tash masi u bo, masi u bo qeveria i murr paret. Me Bujarin [Bukoshin] e patëm bisedu që qato dhetë milionë, nanë milionë e 700 mijë, pata thanë dhetë milionë m’i qit’ për aty, po ai nuk deshti. Mandej jemi taku në Shqipëri me Bujarin, në ministri, aty ku ka qenë thashë, “Ti ke thonë që një fshat m’u bo [sulmu], unë hi me ushtri. Ku e ki ushtrinë? Lufta po kërset atje në Kosovë një. E dyta, ti po del në reklama të televizorit çdo ditë për liri”, thashë, “për liri po luftohet mrena, në Tiranë jo. Ti përpara ke dalë me FARK tash i ke veshë njerëzit me tesha të UÇK-së edhe po shëtitni nëpër Tiranë, që mund ta dëmtojë Shqipërinë”.

U vra... e thirrë me Ahmet Krasniqin që e kanë vra, ushtarakun. Më thotë... unë mora vesh që Bujari osht’ në Tiranë, po i thom, “Ahmet, Bujari osht’ në Tiranë. A e ke taku?” Tha, “Jo”. “Si mor burrë”,

thashë, “s’e takon”, thashë, “ai ministër i mbrojtjes edhe s’na bjen informata drejtpërdrejtë prej teje si po shkojnë, zhvillohen ngjarjet”. Tha, “Dërmak”, tha, “unë kom bo ni elaborat. Jom në përfundim e sipër, kam me ia dorëzë Bujar Bukoshit. Nëse don me pranë elaboratin se si zhvillohet mbrojtja, lufta, mirë. Nëse jo, kam dy rrugë: m’u kthy në Zvicërr dhe ose me hi në luftë vet”. Mandej, kur e vrajtën tash, mbeti Halil Bica zëvendës i tij.

U mbledhëm me ni takim, po i thom Azem Sylës, ishte ministër i mbrojtjes. Atij ia kishin dhënë logjistikën, me gjasë si me qenë ministër në kuadër të UÇK-së. Ai edhe nuk e ka pranë me qëllim që sigurisht ju ka dokë gradim i vogël. I thom Azemit, “E bojmë ni zëvendës kryeministër të dytë, se si ministër s’po i duket, s’po i pëlqen”. “Po, e bojmë”. Dolëm, i thashë, “M’u bo bashkë që edhe po të bojmë, ministri po pranë me qenë zëvendës ministri i dytë”. Ai ka të jenë pa u konsultu me Bujarin. Thashë, “Shiko me hi dy ushtri në Kosovë, kem me u vra në mes veti. Osht’ hera e fundit që po bisedojmë në tavolinë. A shqiptartë, bijtë e nanave shqiptare, ka me u derdhë gjaku a na kena me nejt në terun. Prandaj ki parasysh këtë”, thashë, “sikur në Bosnje që kanë hi dy ushtri”, atij tradhëtari si e pat’ emrin atje? “Po, po”. Masanej ata janë nisë rrugës i kanë çarmatosë në Tropojë. Mandej, këtu kur janë ardhë ia kanë marrë edhe uniformën, se UÇK-ja pa luftë nuk ka.

Anita Susuri: E ju në Zvicërr keni organizu edhe peticione, protesta...

Sami Dërmaku: Po, protesta. Dy greva ka ni javë i kemi mbajtë para Kombeve të Bashkume. Bile, sa ishim në grevë, ai përfaqësuesi i Shqipërisë kqyrke me na përshëndet. Po ia boj, “O ku je shqipe bre?” Tana kur dilshim shpërndajshim pamfleta. Prej Kombeve të Bashkume ato, punë dore që ishin ato delegacione. Na secilit aty te dera ia jepshin ka ni pamflet.

Anita Susuri: E ato pamfletet çka kanë shkru?

Sami Dërmaku: Po qaty. Dhunimi, shfrytëzimi. Pamfleta kundër okupimit. Ti e ke pa qysh kom folë unë aty, duhet me kallë publikun.

Anita Susuri: E pamfletët në gjuhën angleze kanë qenë?

Sami Dërmaku: Po, frangjisht, frangjisht kryesisht, frangjisht. Bile, t’u ia dhanë të tjerëve qëllon përfaqësuesi i Shqipërisë i thashë, “Merre edhe ty të vyn kjo”.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: E këto domethonë protestat që janë bo, e pashë prej videos që ma dërgut që janë konë mjaft masive me thanë...

Sami Dërmaku: Po.

Anita Susuri: Qysh janë shpërnda kaq shumë lajmi që po bohen protesta?

Sami Dërmaku: Jo, jo, organizatë pas organizate, brez pas, pas mysafirëve e shokëve e të tjerë.

Anita Susuri: Ka pasë edhe burra e gra?

Sami Dërmaku: E ke pa ti, fëmi e gra e burra.

Anita Susuri: Domethonë, ky ka qenë po më duket ni protestë ka qenë në '97-ën...

Sami Dërmaku: Po, '97-ën. Hala pa kris lufta gati.

Anita Susuri: Kjo ka qenë në Gjenevë?

Sami Dërmaku: Jo, në Bern ka qenë. Kryeqytet i Zvicrrës.

Anita Susuri: E kur osht' afri koha si me thanë, kur u ofru koha nuk mujmë me thanë po viti '98...

Sami Dërmaku: Po.

Anita Susuri: A keni punu ose a keni pasë lidhje me ata që po formohet ose veç osht' formu ni ushtri ose sigurisht...

Sami Dërmaku: Po jo shiko, turma s'ka ditë kurgjo. Ata që kanë qenë organizatorë, ata që e kanë mendu. Të holla me mbledhë në Zvicërr ma shumë se unë s'ka mbledhë kërkush, se e kanë ditë që unë nuk boj dallavere, hajni e pislleqe nuk boj. A beso ti nanë milion e 700 mijë, bukën e merrsha me veti, funellën, kafën, qumështin hisha në parking hajsha bukë, pushojsha pak, kafën e bojsha edhe nëpër Zvicërr në qytet më qytet, që kurrë menja s'më ka shku në jetë tem që ta marr bre prej kësaj [buxhetit] ni kafe ta pij. Unë kom shku inxhinier atje, kom mujtë me punu si inxhinier me marrë rrogën dhetë mijë franga, 15 mijë franga, a kom jetu me ndihma sociale. Thojsha se s'jom dalë unë me fitu, me përfitu këtu, jom dalë me organizu këtu.

Anita Susuri: Dashta me ju pytë, përveç ktyne organizimeve këtu që keni bo, aktivitete a keni punu diçka?

Sami Dërmaku: Jo, jo, me ndihma sociale jom marrë. Kaniherë ka bo vakia fëmija s'ka pasë qumësht m'i dhanë lang. Po thom, kurrë ni pare, me vetura të mija, me benzin tim në cep më cep i kom ra edhe

kurrë asni cent [nuk e kam përvetësuar nga ai fond]. Bacës Adem ia kom mbledhë dikund nja 27-28 mijë franga kur ka dalë, Adem Demaçit.

Anita Susuri: Këto paret që kanë dhanë kanë qenë krejt diaspora apo?

Sami Dërmaku: Po, po, krejt diaspora po.

Anita Susuri: Vitin '98 kur filloi, kur veç krisi me thanë lufta, ato sulmet e para, qysh ka qenë për juve kjo periudhë?

Sami Dërmaku: Po shiko, tash ajo puna ma e madhe që u bo. U bo Fondi Gjithëkombëtar, po ato pare i murr qeveria. Na lume shyqyr u bo qeveria jonë, ku dreqi e dinim që kjo do të ketë... tana nuk... problemi osht' si thojnë dy desh kur takohen në urë, bijnë te dytë në lumë. Këta i kanë lypë paret po pa i dhanë funksion. Ai budallë nuk o me të dhanë paret. Ami mu paret. Edhe pse ju ka dhanë. Kurse ai paret i ka pasë, në luftë kërkund hiç. Çka tash?

[Këtu ndërprehet intervista]

Sami Dërmaku: Pas luftës, gjatë luftës, se me Azem Sylën kemi qenë me ni qeli as kemi qenë me ni qeli në Burgun e Prizrenit. Ai e ka ditë kush jom. Unë të LPK-së me këto budallaqe marksizëm-leninizëm e këto i kritikojsha se kisha bagazh. Edhe kur del Azem Sylja jashtë në perëndim thotë... se isha kryetar i Bashkësisë të Klubeve dhe Shoqatave në Zvicërr. Ai e dike që unë mbledhi pare, "Pare po na vyn". Meqenëse, Bujarit ia lypa ato pare, nuk i qiti me arsyetim se çfarë ministra kom unë s'muj m'i qit ato. Po më thotë, "Ti me bo me ni grup me mbledhë pare me m'i dhanë mu, se jom një nga të parët në protesta". Nuk qiten pare në kutia se nuk e dishin ku shkojnë e tek shkojnë, po m'i qit të hollat në bankë.

Thashë, "Kur vjen puna e mbledhjes të hollave në dorë, ka marrë fund kjo punë". "Ti", po thotë, "a ki kujt me ia dhanë?" "Po". "Kujt?" "Komandantit". "Cili ishte komandant?" Thashë, "Azem Sylja", "A bon me shënu?" "Shënoje", thashë. Po tha, "A bon m'i mbledhë ti?" Thashë, "A m'i çu unë ato pare?" Tha, "Bon, po ty t'i marrin në doganë. E unë jom kryeministër, s'ma çelin kuferin me hallakat e m'i çu". "Që i çon mirë". Thashë, "Ti", thashë, "ato pare që ke marrë", se tha, "Nuk muj m'i ngjeh ato pare se janë fond humanitar, jo për luftë", thashë, "Jo, kollaj osht" thashë, "ti blen", thashë, "teknikë të bardhë", thashë, "edhe t'i çojnë armtë me helikopter aty ku të kish qef ti", thashë, "nuk osht' e vërtetë kjo", thashë.

Në ndërkohë e boni Këshillin e Emërgjencës për Fondin Vendlindja Thërret. Emergjente ishte puna e luftës, nuk ishte kumeditë çka. Ata nuk janë budallë zvicrrantë. Thashë, "Ti nuk munësh m'i mashtro ata". "E bon Këshilli Emergjent". Thashë, "Pse e bon Këshilli Emergjent", thashë, "emergjente është lufta, nuk ka kurgjo tjetër", thashë, "ma tepër", thashë. Unë thashë, "Ka me bo", thashë, "të kundërtën.

Ka me bo Shtabi i Moblizimit për Fondin Vendlindja Thërret”. Bile u bo aty, me ni tubim i mbledhëm gati njiqind mijë franga. Mirëpo, këta të Lëvizjes, disa që ishin aty, nga frika që po bohet ky fond sikurse Fondi Gjithëkombëtar e po mbetet e anashkalume Fondi Vendlindja Thërret e sabotun.

E thirri Azemin, “Ti më the pare me mbledhë. Unë fillova pare me mbledhë”, thashë, “këta e sabotun”, thashë, “shoktë e tu”. Se mu më tha kur erdh, “Dërmak”, tha, “ty s’po të dojshin hiç”, tha, “po me mu ki punë”, a din. Bile, ka qenë ai Xheladin Gashi, Komandant Plaku, pak rrijke si i egër, a din. Kumeditë. Kur erdh këtu thashë, “Pse rrishe egër me mu?” Tha, “Ku e disha që kishe lidhje me Dajën ti”, se Azemi e ka pasë pseudonimin [Dajë]. Mandej hypi unë veturës, po mendoj me ni kamion mrrri deri në Shqipëri. Thashë, “Kqyre”, thashë, “ma ke bo të padrejtë”, thashë, “ti më tha me mbledhë pare. Paret”, thashë, “fillova m’i mbledhë”, thashë, “ata e sabotun”, thashë, “unë s’kom çka rri atje”, thashë. Thashë, “Jom ardhë për me shku në luftë. Mirëpo, jom invalid s’e kom miniskus, ligament edhe frakturë”. Bile ishte edhe Jakup Krasniqi, “Le allahile, njerëzit e ri po na rrijnë me patlixhona t’u hongër e s’po mujmi m’i shty, le ti i vjetër”.

Atëherë mbeta në kuadër të ministrisë aty që ishte Azemi, në kabinetin e tij. Pastaj... bile kisha ni pistol të mirë, ai Fatmir Limaj, “Masi s’po vjen në luftë bima bile pistoletën le të vrasin” (qeshë). Ma dha ai ni pistoletë të vetën. “Kur kryhet lufta”, thashë, “e kthen”. Atë pistole e merr Kadri [Veseli], ky Kadria i SHIK-ut, interesant. Jo masanej më vijnë në mend. Kadri Veseli. Atë pistolen tem e merr Kadria. “Pse”, thashë, “ia ke dhanë atij?” Tha, “Valla, si ka thanë baci Samiu, e ka marrë”, a din. Tani ia çova edhe letrat, a din, mos me i zanë problem. E tani prej atyhit masi hini NATO, erdh KFOR-i, atëherë na u tërhjekum në Kosovë. Në kuadër të ministrisë kom qenë M1, ministër i mbrojtjes.

Unë e pashë... mos rrehi dikush në derë [i drejtohet intervistuesës]... unë e pashë çka janë t’u bo e si sillen. Dashta me dhanë dorëheqje, se e pata shkru ni artikull, “Kom frikë se mafija do të vijë në pushtet”, se e shifsha çka po bohet. Vjen Fatmir Limaj tha, unë e shkrujta shumë ashpër. Xheladin Gashi, Komandant Plaku, “O burrë”, thojke, “zbute pak se po na vjen inati prej ktyne tjerve”. A din, e pasha çka bohej. Fatmir Limaj tha, “Ku pin”, tha, “ujë ti?” Thashë, “Shiko”, thashë, “unë pi ujë te e vërteta. E vërteta ka qenë ma e hidhur se çka ka me ndryshu tash. Po falë”, thashë, “Xheladin Gashit, Komandant Plakut”, thashë, “na e kemi zbutë e kemi qitë”. E mirë. Masanej ku pijke ujë ai, pislleqet e tij nëpër burgje, nëpër... s’e di a e ke pa.

Më thotë mu Azem Sylja... jo, pata me dhonë dorëheqje ma herët. Ramadan Avdiu edhe do shokë, “Ma mos jep dorëheqje me na qit’ ftyrën e zezë, po edhe ni muj ditë shpërbahet kjo qeveri e mos u ngut”. Prita. Masi përfundoi, se s’po du me zgjatë në detale. Masi përfundoi po më thotë Azem Sylja, “Ti Dërmak”, tha, “çka don me bo tash?” Thashë, “Unë ma për jetë me këta bandida nuk kam me qenë”, thashë, “jom inxhinier me profesion po shkoj”, thashë, “në profesionin tim, po punoj në KEK”. Në KEK isha te Drejtoria e Sigurimit të KEK-ut.

Mandej, masi pata telashe kisha problem me zemër, shkova e vnova ni stentë atje. Po i thom Azem Sylës, “Shiko”, thashë, “ti je burgosë, je rritë jetim pa nanë”, se nana iu ka përvlu, “e ke lanë ni babë si ni gurë oxhaku, tërhiq bre boll ke bo. Dy herë burg të kanë torturu, të kanë malltretu, ke organizu lufta, ke udhëheq. Tërhiq nëse don me mbetë pastër”. “Jo më thojnë shoktë që na la Daja, u tërhjekë s’po don me neve me vazhdu rrugën”. Thashë, “Po, po me këta faqe të bardhë nuk qet”. Edhe kështu i ndodhi. Kur ra në burg e dulë prej burgut i thashë, e kom shkru kështu, “Dyshoj se e ka bo, ne paqt bo e bajt me shnet”.

Mo s’jom dalë, mo s’jom dalë në votime. Herën e parë jom dalë në votime t’u mendu, t’u mendu që janë njerëz. “UÇK, UÇK”. Thashë, “Mirë more Azem, po ne që kemi qenë nëpër burgje, e njerëz që kanë ardhë në arkivol e sakata të gjymtum nga torturat, çka janë kta? A jemi dikushi ne a veç UÇK në këtë dynja”, thashë, “dojnë me ça qiellin t’u bërtitë”. Kështu dola mandej punova në KEK ni kohë. E pata ni operacion në zemër, ni stentë me vnu atëherë u tërhjeka krejt. Më vjen keq se kom hjekë derisa e kom kry fakultetin, atë profesion, e ma së paku më ka ra me ushtru. Po.

Anita Susuri: Me çka jeni marrë pastaj?

Sami Dërmaku: Jo pastaj me shkrime, qishtu me shkrime.

Anita Susuri: Ju më thatë që keni dokumentu edhe tregime të bashkë, si me thanë, bashkëluftëtarëve...

Sami Dërmaku: Bashkëveprimtarëve.

Anita Susuri: Bashkëveprimtarëve...

Sami Dërmaku: Po, i pata bo 2001, 2002 masi jom kthy. Po s’e kom mendu që vjen koha najherë që duhet ta... se s’i disha kush i transkripton. Tani tri euro faqen dikund nja ni mijë e kusur ka kushtu kjo. Ni kontratë e lidha po nuk e mora vesh, duhna me bisedu, si duket nuk janë kah m’i mbulojnë as shpenzimet. Pata fjalë të mdhaja, po mandej po tërhjeken.

Anita Susuri: Tash keni me botu si libër a?

Sami Dërmaku: Po, po, si libër edhe inxhizimi osht’ dixhital në USB.

Anita Susuri: Zoti Sami, sa fëmi i keni? Ku janë fëmitë e juj? Me çka merren?

Sami Dërmaku: Unë i kom katër fëmi. Vlora e madhja, i ka dy vajza të mira. Kanë ble shpi në Francë edhe ka maru shpi këtu. Vajzat i ka të mrekullueshme, të zgjuta shumë. Vajza e madhe osht’ kah i kry për avokaturë magjistraturën. Kurse unë, djali i madh, ka kry magjistraturë, baqelorin për

marrëdhënie ndërkombëtare, magjistraturën e ka kry ekonomist-sociologji. Tash e ka marrë magjistraturën për avokat. E ka përfundu edhe vazhdon me kry stazhin.

Vajza e dytë, mas tij, ajo e ka kry magjistraturën e ka gjetë stazhin për avokate edhe ajo avokate. Vazhdon prapë në magjistraturë tjetër për me kompjuter, po. Djali i vogël tash ka hi në spital e kry stazhin edhe i jep disa provime për në vjet e gjys edhe mandej osht' i pavarur. Deri tash ka punu kështu punë që mos me nejt kot. E kish pare nja tre mijë franga e tha, "O në jetë teme kurrë s'kom pasë pare ma shumë" (qeshë).

Anita Susuri: E tash atje jeni i vendosun apo? Në Gjenevë?

Sami Dërmaku: Po, po, po na këtu jetojmë ma shumë. Këtu jetojmë ma shumë, fëmija janë atje, vijnë kohë pas kohe najherë këtu.

Anita Susuri: Shumë mirë.

Sami Dërmaku: Po, po, po për zvicrranë. Unë ju kom thanë, "Edhe njëqind herë me punu e me bo be për Zvicrrën, ju jeni të huj". Ata e kanë gjermanisht *gasterbajt*⁹, a çka ju thojnë atyne. Megjithatë edhe atje racizmi, nuk osht' si te na, po racizmi... çka osht' ma keq në Zvicërr, kuadrot e tjera në administratën zvicrrane shumë ma të poshtër janë sesa zvicranët, se dojnë me dhanë prova ata. Unë kur jom shku tash s'kishte përkthyes shqiptarë. Tash e prunën në Steva ka qenë i kohës Titiste kur ka dalë në Zvicrrës, po mendoj mas luftës të '45-tës që ka qenë me çetnikë, që ka dalë. Ka marrë shtetësinë zvicërrane.

Mu më thojshin me folë serbisht. Unë thashë, "Nuk foli serbisht se s'e di gjuhën", thojsha, "Qysh s'e din gjuhën ke kry fakultet?" Thojke ai shkau, "Edhe je konë ushtar e s'pe din gjuhën". Dikur thashë, "O ti zotëri", se thojke ai shefi i, zvicrran i policisë, "Foli ti kësaj përkthyes shqip kjo le ta përkthen, t'ja përkthen ktina frengjisht", se ai frengjisht. Thashë, "Jo koftë ashtu ju bine në kinez, kjo p'i folë", thashë, "frengjisht, kinezi tani këtij". Dikur tha, thashë, "O ti", thashë, "ti nuk munësh me më detyru mu qysh me folë", thashë, thashë, "ky zotëriu nuk ka ikë pse ka vra shqiptarë me tenka e me, ka bo gërdi", edhe thashë, "çetnikët e tij janë ka bojnë gerdi në Kosovë", thashë, "nuk e foli gjuhën e armikut, a more vesh tashti?" Tha, "Ti a kujtove që të kemi pytë me trëndafila a?" Thashë, "Jo s'kom kujtu që ti më pret me trëndafila. ama kom mendu që jeni shtet demokratik".

Merre me mend më çunë me në podrum. Pat lind vajza, filloi myku. As s'më kanë lonë me punu, as s'më kanë lanë me, me hi në punë edhe me marrë banesë si të gjithë tjerët. Po thotë në shok, "Shko te filan..." si duket kryeshef ka qenë Medvedeva, rus i ardhun. Ka qenë në shef i UDB-së Goc i thojshin. Tha, "Shko te ai". Si duket këta konflikt me atë thashë, "O zotëri", thashë, "mu m'ka lind vajza në

⁹ Gastarbeiter (gjermanisht: Gastarbeiter - "punëtor mysafir") është emri për punëtorët e huaj që erdhën në Gjermani në mënyrë të organizuar në vitet 1960 dhe 1970 për punë të përkohshme.

podrum, podrumi ka lagështi. Që sa vite jom aty. Ama të lutëm, a ka unë... kurgjo s'po du ma tepër", thashë, se ata më kanë thanë, "Kur grumbullohen edhe tjerë emigrantë prej Kosovës të shtijmë edhe ty". "Unë sa e sa emigrant vijnë", thashë, "që i njoh", thashë, "s'shkon tre-katër muj ditë e merr vendimin. Unë tri vjet po pres", thashë, "tek e fundit, unë du përgjegje. Pavarësisht qysh po ikni. Bota e madhe dal tjetërkund", thashë, "po unë kujtova që jeni shtet demokratik". "Mas nja dy jave", tha, "thirrëm".

Pas dy jave vjen lajmi me shku në Bern, në Bern m'u taku atje. Tash unë i kisha marrë gazetatat serbisht, "Nin-in" e "Vesti" e çka po di unë. Vjen ajo shefja, ishte gru e vjetër serioze. "A zotëri Dërmaku ju p'e dishi serbishtën", se i kanë thanë që s'di serbisht. Thashë, "E di për mrekulli". Tha, "Po mirë", tha, "qe e kemi këtë serbin këtu", tha, "serbisht me folë". Thashë, "Jo, zojë, nuk foli", thashë, "serbisht. Ni armik që ma masakron emrin tim, nuk du me ia ditë as gjuhën as me folë gjuhën e tij", thashë. Ai erdh hini, mendja e tij që rrin aty. Tha, "Çka me bo?" Thashë, "Çka me bo? Qishte qysh po di frëngjisht", thashë, "po folum", "E ky?" Thashë, "Jo, jo, para këtij s'foli unë", thashë, "se ky mun me lajmëru në UDB-e atje e m'i tregu shoktë e krejt. Unë s'foli para këtij", thashë.

U çu ai, më fal, si bagla në shi. E me to tani herë me gishta herë me dorë (qeshë). Shkaktar unë jom bo kanë fillu shqiptarë m'u bo përkthyes, se deri atëherë s'ka pasë përkthyes. Nime e kom psu, po karakteri osht' karakter. S'ka çmim që munesh me m'thy. "Jo", tha, "kujtova që me trëndafila po të presim". "Jo", thashë, "kujtova që jeni shtet demokratik", thashë.

Anita Susuri: Zoti Sami nëse nuk keni edhe diçka tjetër me shtu, ju kisha falënderu shumë...

Sami Dërmaku: Faleminderit edhe prej juve!

Anita Susuri: Edhe për kontributin.

Sami Dërmaku: Ndoshta pak kom shku cik cak, po megjithatë osht' thanë.

Anita Susuri: Qashtu funksionon mendja, qashtu, s'osht' problem. Shumë mirë. Faleminderit shumë!

Sami Dërmaku: Po.